

Akoma nuk keni një website?

Akoma nuk jeni regjistruar në Google

Për çdo konsultim mund te vini në çdo kohë në zyrat tona

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT
Tel:020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob:078 5997 7545



The Albanian

VITI I 20 I BOTIMIT 25 MARS 2024

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

700 SHQIPTARË

JANË DEPORTUAR NGA BRITANIA GJATË PERIUDHËS JANAR-MARS 2024



PETRIT KUÇANA

**ÇFARË DO TË
NDODHË ME TË
RIATDHESUARIT?**



ARBEN MANAJ

**SI PO PASUROHEN
GRUPET KRIMINALE
NGA TRAFIKU
I EMIGRANTËVE
DREJT ANGLISË**


**TËHUAZIMI I
SHQIPTARËVE NË
MAQEDONINË E VERIUT**

DAUT DAUTI



**PASTRIMIN E PARAVE
E BËJNË PASTRUESËT**

LUTFI DERVISHI




**“E DREJTA E MEDIAS”
ÇËSHTJA “AMBROZIA
META”?**

MAL BERISHA



**NJË ÇERK SHEKULLI
NGA FUSHATA
AJRORE E NATO-S**

ZENEL KUÇANA



**MINISTRIA
E KUJTESËS**

VETON SURROI



E ARDHMJA FILLON TANI

Dotech
websites

**JEPI FRYMËMARRJE
BIZNESIT TËND**



PËR ÇDO KONSULTIM
MUND TE VINI NË
ZYRAT TONA

ADRESA E ZYRAVE:
30 AVENONS ROAD
LONDON E13 8HT

020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545


The Albanian newspaper in London

THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

E frikshme ngjason shifra prej 700 shqiptarëve të kthyer nga Mbretëria e Bashkuar nga janari në mars të këtij viti. Natyrisht që konsiderohet sukses i qeverisë britanike, rrjedhojë e marrëveshjes Rama-Sunak për depërtimin e shqiptarëve.

Por ka një pyetje themelore; -Çdo të bëhet me shqiptarët e kthyer?

-A ka dikush që i pret dhe kujdeset për ri-integrimin e tyre? Dikush që i pret në aeroport që kujdesen që të mbërrin në destinacionet e tyre, se mbase nuk kanë as lekët e biletës?

Dikush që quhet shtet që menaxhon taksat e shqiptarëve, pikërisht për tu kujdesur për shqiptarët?!... sidomos në ditët më të vështira të tyre.

Janë shumë e shumë histori kur shqiptarët kanë shitur shtëpitë dhe pronat e tyre dhe tani s'kanë ku të kthehen...kut ë thynjë qafën e të shkojnë....

E shteti vazhdon të mbetet inekzistent.

A mundet që të ri-atdhesuarit, të debuarit të jenë (bien) pre e grupeve kriminale, pasi kanë humbur gjithçka dhe nuk kanë asnjë shpresë për ri-integrim?

A ka ndonjë statistikë nga strukturat shtetërore për të rikthyerit sërish në Britani. (Ka kronika të pafundme



në masmedian britanike) Dhe?...

Ka një fakt terësisht kokfortë, që duket se nuk çon peshë tek autoritetet shqiptare; shteti shqiptar nuk gjendet pranë shqiptarëve, si detyrim kushtetues (neni 8), edhe kur ata humbin jetën, kur kanë më shumë nevojë se kurrë për ngrehinën shtet. Të paktën në tre raste në Britaninë e Madhe, kur shtetasit shqiptar kanë humbur jetën, shteti shqiptar vazhdon

të jetë i munguar.

Nuk u gjend pranë familjarëve pr kthimin e arkmortëve në atdhe.

Asnjë fjalë nuk është dëgjuar nga KKD-ja (Këshilli Koordinues i Diasporës). Mbase shumica e shqiptarëve as që e dijnë që ekziston një strukturë e tillë, e zgjedhur nga qeveria shqiptare.

Shkurt e shqip, janë ata që i thërret kryeministri për të bërë ndonjë foto me ta dhe u thotë se janë përfaqësues të diasporës, dhe ata duket se më

shumë se çdo gjë, dijnë vetëm të heshtin. Mbrojtja e interesve të shqiptarëve në botë, vota e Diasporës?... A mund të ishin ca kauza, gjithmonë nëse nuk do të heshtnin dhe të prisnin mbledhjen e radhës, (një ose dy në vit) me bileta të paguara me hotele të rezervuara dhe opa një foto me KM apo anëtarë të tjerë të qeverisë.

A do të votojë diaspora në zgjedhjet e ardhshme në Shqipëri?

Kush mund të përgjigjëj për këtë dhe a mund të ketë më kuptim pasja e një KKD-je, nëse kjo nuk realizohet.

Apo qeveria bën demok i ka përfaqësuesit e diasporës, e KKD-ja bën demok po kujdeset për diasporës, pra shqiptarët që jetojnë jashtë?...

Apo nuk ua fishkëllen kush KKD-së dhe ata janë pajtuar me këtë status?... Sikur të merrnin një leksion nga Kosova...

AVOKATET E EMIGRACIONIT PËR SHQIPTARËT NË UK

HA Haris Ali Solicitors

If you are a child born in the UK with no immigration status, after 7 years in the UK you can apply straightaway for indefinite leave to remain (ILR).

Call: 0208 8570 7300 | Mobile: 07967 467414 | www.harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road. Hounslow, London. TW3 1PA

IMPERIUM CHAMBERS

(ZYRE LIGJORE ME BARISTER TE KUALIFIKUAR PREJ 25-VITESH)

A JENI KONFUZ NGA
NDRYSHIMET E SHUMTA
LIGJORE TE EMIGRACIONIT DHE
KENI NEVOJE PER NDIHME DHE
QARTESI?!

-NUK JENI
VETEMI!

Tel 1: 07901181592

Tel 2: 02072423488

Address: Thanet House, 231-232
Strand, Temple, London,
WC2R 1DA

NE JEMI TE SPECIALIZUAR NE CDO FUSHE TE EMIGRACIONIT

DHE OFROJME NDIHME ME GJITHCKA PERFSHIRE:

Refuzimin e azilit pa te drejte gjyqi
Aplikime/ri-aplikime nga e para
Apelime ne te gjitha gjykatat
Bashkime familjare ose visite ne uk



TELEFONONI **ADELEN** NE **07901181592** PER T'U KONSULTUAR



Keni nje Bizness qe po rritet?

**DONI TE MERNI PUNETOR NGA SHQIPERIA NE
ANGLI?**

TE SPECIALIZUAR NE

BUSSINESS IMMIGRATION
OFROJME APLIKIM TE SIGURTE PER
SPONSORSHIP LICENSE

Bizneset perfshijne:


Kompani ndertimi
Restorante/café
Car washes

Care homes
Office work
Berber

***DHE SHUME BIZNESE TE TJERA**

SHERBIMET QE OFROJME:

- Human Rights
- Judicial Review
- Appeals
- Fresh Claims
- Asylum
- Overstayers
- Stateless
- Detention and Bail
- EEA Family Permit
- ILR/Natyratisation
- Change of Nationality from Kosovan to Albanian
- Work and Student Visa
- Spouse Visa
- Visitor Visa
- Divorce



Email:
adela.bushi@imperiumchambers.co.uk
enquiries@imperiumchambers.co.uk
Website:
www.imperiumchambers.co.uk
YouTube:
The Immigration Barrister



ARBEN MANAJ

Grupet kriminale që merren me trafikimin e klandestinëve me gomone në La Mansh, fitojnë 1,6 milionë sterlina në ditë. Sipas burimeve mediatike që i referohen opozitës laburiste, e cila pritet të fitojë zgjedhjet e ardhshme në Britani, trafikantët e qenieve njerëzore u marrin 4 mijë sterlina çdo emigranti që kalojnë me gomone nga Franca drejt brigjeve angleze.

Kalimet ilegale me gomone nga Franca drejt Britanisë ende vazhdojnë dhe që kur ka marrë drejtimin e qeverisë kryeministri

Rishi Sunak, 40 mijë emigrantë ilegalë kanë mbërritur në Britani, duke kaluar La Manshin. Sipas burimeve franceze që i referohet Partia Laburiste e opozitës e cila mendohet gjerësisht se do fitojë bindshëm zgjedhjet e ardhshme parlamentare, trafikantët fitojnë 1.6 milionë sterlina në ditë nga trafikimi i emigrantëve me gomone dhe çdo emigrant paguan 4 mijë sterlina.

400 emigrantë mbërritën vetëm më 4 mars, c'ka është shifra më e lartë e 2024-ës. Ministrja hije e Punëve të Brendshme nga opozita Yvette Cooper thotë se "në vend të harxhimit dhe shpërdorimit të miliarda sterlinave për planin e dështuar të Ruandës, Laburistët në pushtet do luftojnë grupet kriminale që operojnë gomonet përmes



një njësie ndërkufitare për shkatërrimin e modelit të tyre të biznesit".

Nderkohe dy shqiptare janë shpal-

lur fajtor nga një gjykate britanike kete fundjave per trafikimin me avjone te emigranteve nga Franca drejt Anglise jugore. Pas nje hetimi 8 vjecar te Agjensie britanike

te Luftes kunder Krimin, NCA, u konfirmuan te pakten nen udhetime me avjon te vegjel nga veriu i Frances drejt jugut te Anglise te emigranteve ilegale per iudhen e viteve 2016-2017, dhe disa udhetime me kamione te emigranteve te trafikuar.

Ne procesin gjyqesor u tha se emigrantet shqiptar paguanin per keto udhetime 10 mije sterlina, pervec parave per dokumentat fallco. Dy pilotet anglez jane denuar ne France, nderkohe shqiptaret e shpallur fajtor pritet te denohen ne maj te ketij viti.

Ne kuader te operacionit te NCA u bene 27 arrestime dhe 11 denime nga te cilat 9 jashte Britanise. tch

HA
HARIS ALI SOLICITORS

KONSULTIMET FALAS

OFFICE: 020 8570 7300 / MOBILE: 07967 467414

We are **Immigration Experts** who have a high success rate in representing thousands of **Albanian** clients with a variety of immigration issues. We have a highly experienced team of immigration solicitors and barristers.


- Asylum / Trafficking
- Overstayers / Human Rights
- Detention & Bail
- Appeals & Judicial Review
- Fresh Claims / Further Submissions
- Indefinite Leave To Remain / Nationality
- EEA Permits / Stateless / Deprivation
- Spouse Visas / Children's Visas

Email: contact@harisalisolicitors.co.uk

19 Kingsley Road, Hounslow, London, TW3 1PA | www.harisalisolicitors.co.uk

POROSISNI BUSINESS CARDS

Dotech
websites



Websites 01

Business Cards 02

Banners 03

Marketing 04



020 7018 7929
073 4066 5946
078 5997 7545



ADRESA E ZYRAVE:
30 AVENONS ROAD
LONDON, E13 8HT

ALFRED LELA

Në romanet e autorëve latino-amerikanë caudillo-t abuzivë, në fund të moshës dhe karrierës kthehen në impotentë që lagin shtratin. Në fund të Luftës së Ftohtë, diktatori rumun Çausheku, që për disa dekada sundoi me dorë të hekurt, pati një vdekje tragjikomike. Manule Noriega përjetoi gjithashtu një fund qesharak. Në kontekstin që don të ilustrojë ky shkrim, me qesharak do të kuptojmë gjendjen apo fundin e njerëzve dhe regjimeve politike që kanë pretenduar për një kohë të gjatë një gjë, dhe janë përmbyllur me krejt të kundërtën. Si qesharake shihet rënia e tyre në raport me fuqinë dhe pretendimet e veta.

Në këtë rrafsh, edhe regjimi i Edi Ramës po kthehet në qesharak, çka do të thotë se është drejt fundit. Rama e nisi si kryeministër, duke shembur me tritol disa ndërtesa apo duke publikuar fotot e rrangallave të gjetura, me gjasë, në bodrumin e selisë së qeverisë. Ishte mënyra e tij për të thënë se, me ardhjen e Rilindjes në krye të punëve, do të merrte fund rrumpalla e qeverisë paraardhëse demokrate, do të mbizotëronte ligji dhe rregulli, dhe estetika do të ishte fytyra e gjërave.

Kështu, ai shpiku Rilindjen urbane, hoqi gardhin e Kryeministrisë dhe mbolli instalacione në kopështin e saj, për të treguar hapje dhe orientim drejt së bukurës. Në anësoret e autostradës Tiranë-Durrës mbolli palma dhe disa minikupola të çuditshme betoni.

FAZA E FUNDIT E ÇDO REGJIMI SI AI I EDI RAMËS ËSHTË QESHARAKËZIMI

Njerëzit, përjetuan kështu atë që mund të quhet si faza e tronditjes, që vinte sa nga metodologjia e Ramës, aq edhe gjuha e zgjedhur për ta përcjellë. Kjo përzjerje e jakobinizmit me sanguinizmin, e kaloi habinë e fillimit dhe publiku u bë shpërfillës. Pasi e kaloi fazën e dëshirës për të tronditur, Rama u fut në fazën e dytë, që mund të quhet e reformizmit. Pretendimet më të mëdha lidhen me Reformën në Drejtësi, dhe një aneks i saj, vettingu në polici, deri edhe te shfryrja e barkut të madh të policëve. Pa harruar një lejtmotiv, që e kishte bartur nga fushata elektorale, me ndriçimin e një klisheje që, si të gjitha klisjetë është sa banale edhe popullore: “fajin nuk e ka individi, por sistemi”.

11 vjet më vonë mund të thuhet, tashmë me siguri, se regjimi i Ramës është në fazën e fundit, përmbjllëse. Janë tre shembuj ilustrues gjatë javës së fundit që dëshmojnë bash atë se Rilindja ka kaluar nga faza e tronditjes, te reformatorja dhe tashmë fle te qesharakja.

Rasti i parë lidhet me arrestimin nga SPAK të një drejtori të lartë, në varësi të Ministrisë që drejtohet nga zëvendësja e Ramës, B. Balluku. Pas një kontrolli në banesë, drejtorit Berberi iu gjetën disa piktura, të raportuara si të shtrenjta (kjo është një metodë e njohur e botës kriminale për



të fshehur pasuritë e paligjshme apo pastruar para të pista: blerja e pikturave të shtrenjta nga autorë të famshëm të cilat në njëfarë mënyrë ‘ngrijnë’ asetet financiare deri në një moment të dytë kur ato ndërrojnë duar apo shiten, duke e marrë mbrapsht, ndonjëherë edhe të shumëfishuar investimin fillestar). Pretendimi i drejtorit të qeverisë së Rilindjes ishte fantastik: pikturat i kam bërë vetë. Sigurisht, është një pretendim prej të dëshpëruari, sepse nëse policët kontrollues (edhe pse me bark të rënë pas reformave!!!) nuk ia kanë haberin artit, SPAK, edhe pse mund të mos ketë njerëz edhe aq të ngritur në punë

të kulturës, ia kërkon puna që të pajtojë ekspertë arti apo koleksionistë, për të bërë vlerësimin dhe nxjerrë të vërtetën.

Rasti i dytë është edhe më i lezetshëm. Policia lajmëroi se kishte ekstraduar nga Dubai një të kërkuar, shfaqti edhe pamjet kur ai zbriste nga avioni me duar në pranga. Të nesërmen ‘i ekstraduari’ tha krejt të kundërtën. Ai ishte kthyer vetë nga Dubai dhe ishte dorëzuar policisë sapo kishte zbritur në Rinas. Blutë e kishin prangosur edhe e kishin hipur në shkallët e avionit nga i kishin kërkuar që të zbriste në mënyrë që të

mund ta fotografonin dhe t’ja shpërdanin medias këtë ‘sukses’.

Rasti i tretë i përket një sanitareje që e nxirrete jetesën duke pastruar shtëpitë e atyre më mundësi të mira financiare (lexo: njerëz të administratës së Ramës). Njëra prej tyre ishte Ada Klosi ish-drejtoreshë, në banesën e së cilës sanitaria dhe i biri vodhën 500 mijë euro. Në përfundim të hetimeve, Prokuroria kërkoi që vjedhësja e parave të taksapaguesve të dënohej me 1.5 vite burg, kurse sanitaria, që vodhi paratë e vjedhura me 4.8 vite burg. Me logjikë të thjeshtë, shuma e vjedhur ka qenë e njëjtë si për ish-drejtoreshën dhe për sanitaren, pra 500 mijë euro. Ndryshimi do duhej bërë te shpërdorimi i detyrës. Klosi ka shpërdoruar detyrën si funksionare publike, kurse Dobi ka shpërdoruar ‘detyrën’ si sanitare. Në çdo rast, barra e përgjegjësisë dhe e fajit duhet të ishte më e rëndë për ish-zyrtaren. Këto janë vetëm tre episode që kanë dalë në sipërfaqe. Por, që ilustrojnë më së miri banalitetin e së keqes, pra klimatzimin me vjedhjen të qeverisë dhe administratës, korrupsionin, shtrembërimin e së vërtetës nëpërmjet propagandës, me çdo synim dhe çdo kusht.

Nga faza e tronditjes te e reformizmit, regjimi i Ramës ka kaluar te qesharakëzimi. Nuk është për të qeshur, sigurisht sepse shpenzimet e të tria etapave i paguan publiku.

'NATO DUHET TË DËRGOJË MË SHUMË TRUPA NË KOSOVË' - ALBIN KURTI PËR 'THE TELEGRAPH'

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti në një intervistë për gazetën britanike “The Telegraph” ka thënë se Britania duhet të dërgojë më shumë trupa në Kosovë për të parandaluar luftën në Ballkanin Perëndimor.

“Kishte vetëm një prani “simbolike” të NATO-s në vend dhe nuk do të mjaftonte për të parandaluar një pushtim nga Serbia”, tha Kurti për “The Telegraph”.

Prestigjiozja britanike duke e përshkruar intervistën e dhënë nga Kurti thotë se vërejtjet e kryeministrit erdhën pasi Aleksandër Vuçiq, presidenti i Serbisë, la të kuptohet për një përpjekje për të “rimarrë” Kosovën në fillim të kësaj jave, duke thënë se Beogradi do të “presë për momentin më të mirë të mundshëm dhe ne do të shfrytëzojmë mundësinë tonë”.

I pyetur nëse Britania duhet të rrisë praninë e saj ushtarake në rajon, Kurti tha: “Britania e Bashkuar është pjesë e NATO-s dhe ata veprojnë dhe veprojnë në atë mënyrë. Unë besoj se duhet të ketë më shumë trupa të NATO-s në Kosovë”, shkruan “The Telegraph”.

“NATO ka 4,000 trupa në terren në Kosovë, por Kurti tha se vendi i tij mund të mbrohet edhe më mirë dhe se NATO mund dhe duhet të angazhohet më shumë në Kosovë si ushtarakisht ashtu edhe politikisht për shkak të kërcënimit nga Beogradi”.

Britania ishte një pjesë kyçe e koalicionit të NATO-s që ndihmoi Kosovën të fitonte pavarësinë e saj pas shpërthimit të luftës në 1998.

Perëndimi ndërhyri për të ndaluar një fushatë të spastrimit etnik në rajonin me shumicë myslimane të nisur nga Slobodan Millosheviç, presidenti jugosllav. Më shumë se 10,000 njerëz vdiqën në konflikt, me shumicën e banorëve shqiptarë etnikë të Kosovës. Trupat britanike të dislokuara vitin e kaluar

Kurti tha se ai i kishte kërkuar Brukselit për më shumë trupa në Kosovë “disa herë”, përfshirë para pushtimit të plotë të Ukrainës nga Vladimir Putin në shkurt 2022 dhe përsëri vitin e kaluar, kur persona të armatosur serbë sulmuan policinë në veri të vendit.

Rreth 200 trupa britanike u vendosën në rajon pas sulmit në një përpjekje për të ulur tensionet, duke iu bashkuar 400 trupave britanike të stacionuara tashmë atje. Këto trupa shtesë janë larguar që atëherë.

Në kohën e dhunës, Alicia Kearns, kryetarja e komitetit të punëve të jashtme akuzoi Perëndimin për dështimin në mbrojtjen e Kosovës nga agresioni serb dhe rus dhe i kërkoi



qeverisë të “sigurojë që ne të mos miratojmë një politikë në qendër të Beogradit për Ballkanin. “Qeveritë e SHBA-së dhe Britanisë e kishin akuzuar Kurti për nxitjen e tensioneve duke nxitur kryebashkiakët shqiptarë etnikë në rajonet kufitare të Kosovës me shumicë serbe. “Analistët kanë paralajmëruar se propaganda e Kremlinit po nxit trazira në veri në një komb ku 93 për qind janë shqiptarë dhe 4 për qind janë serbë”, shkruan “The Telegraph”.

Serbia aleate e Rosisë

Serbia është një aleate tradicionale e Moskës dhe ka refuzuar të sanksionojë Rusinë pas pushtimit të Ukrainës.

Sot, 45 trupa britanike janë të përfshirë në kontingjentin prej 4443 trupash të NATO-s në Kosovë. Në krahasim, Hungaria ka siguruar 365 trupa, Amerika 572 dhe Italia 1322.

“Kurti pranoi se ndërsa prania e trupave ishte “substanciale” në verium me shumicë etnike-serbe, në përgjithësi ajo nuk ishte rritur “shumë” dhe ishte “përgjithësisht simbolike”. Z. Kurti tregoi imazhet ajrore të The Telegraph që përshkruanin 41 kazerma ushtarake në Serbi, të cilat ai pretendoi se ishin të pozicionuara në mënyrë strategjike për të “mbrojtur Beogradin dhe për të sulmuar Kosovën”, shkruan prestigjiozja britanike.

“Putini i vogël”

“Shqetësimi më i madh i Kurtit si udhëheqës i Kosovës është Vuçiq, të cilin ai e përshkroi si “Putinin e Vogël” për shkak të miqësisë së tij me presidentin rus.

Ai tha se “nuk ishte çudi” që në dhjetor të vitit të kaluar Vuçiq tregoi admirim publik për Ilham Aliyev, presidentin e Azerbajxhanit, kur mori rajonin e diskutueshëm të Nagorno-Karabakut nga forcat armene, duke pasur parasysh ambicien e tij për të pushtuar Kosovën”, shkruan “The Telegraph”.

“Për shkak të kërcënimit që Serbia po na paraqet dhe për shkak të lidhjeve të shumta me Kremlinin, më shumë kapacitete dhe aftësi për ushtrinë dhe policinë tonë dhe më shumë trupa të NATO-s do të rrisin sigurinë e vendit tonë dhe të rajonit” theksoi Kurti.

“Besoj që për aq kohë sa Serbia nuk e njeh Kosovën, përderisa Serbia mban 48 baza operative përpara rreth vendit tonë dhe për sa kohë Serbia është aleate e ngushtë e Kremlinit, duhet të ketë më shumë kapacitete nga ana jonë dhe më shumë trupa të NATO-s”, ka thënë kryeministri Kurti. RTK

700 SHQIPTARË JANË DEPORTUAR NGA ANGLIA GJATË PERIUDHËS JANAR-MARS 2024

Mësohen shifrat sa është numri shtetasve shqiptarë të dëbuar nga Britania e Madhe si persona pa leje qëndrimi.

Ministria e Punëve të Brendshme Home Office, të cilës i referohet Top Channel thotë se gjatë periudhës Janar-24 Mars 2024, janë 700 qytetarë shqiptarë të deportuar.

Ata thotë Home Office u riadhesuan përmes 15 fluturimeve charter nga aeroporti Birminghamit dhe Luton në drejtim të Rinasit.

Të dëbuarit sipas Home Office janë të tre kategorive.

Ata të cilët përfundojnë dënimet në burgjet angleze, ata që kapen dhe rezultojnë se nuk kanë leje qëndrimi si dhe ata të cilëve u refuzohet azili.

Ministria e Punëve të Brendshme Home Office ka marrëveshje ripranimi të emigrantëve, vetëm me dy vende në Europë.

Shqipërinë dhe Rumaninë.

Gjatë 2023 nga Britania e Madhe u dëbuan në total 2,501 shqiptarë ndërkohë pritisshmëria e Home Office është për ta dyfishuar këtë numër deri në Dhjetor 2024.



Shqiptarët e dëbuar nga Anglia futen në sistemin TIMS ku shënohet edhe arsyeja e dëbimit përfshi veprat penale për ata që kanë qenë

të dënuar.

Atyre u ndalohet futja në zonën Shengen për tre vjet pasi e kanë përdorur zonën Shengen për tu

futur ilegalisht në Angli.

Statistikat tregojnë se vitin e shkuar kërkuar azil në Britaninë e Madhe 3,898 shqiptarë krahasuar

me 17,340 gjatë 2022 prej të cilëve rreth 13,000 mbërritën me gomone. TCH

Shqipëria është një vend që ka nisur rrugën e pakthyeshme drejt Bashkimit Europian.

Ritmet e rritjes ekonomike janë të krahasueshme apo dhe më të larta sesa rajoni. Vendi po kthehet në një destinacion turistik, me hyrjet e të huajve që po rriten me ritme dyshifrore., të tërhequr nga çmimet e ulëta, bukuritë e shumta natyrore e trashëgiminë historike.

Megjithatë, vetë shqiptarët po vijnë të ikin me ritme që janë ndër më të lartat në botë, në raport me popullsinë, duke u drejtuar në shtetet e Bashkimit Europian për të kërkuar azil.


Ndonëse ritmet e ikjes u ngadalësuan disi në vitin 2023, sërish mbeten tepër të larta, në një vend që sot zyrtarisht ka rreth 2.7 milionë banorë, por të saktë këtë shifër do të tregojë vetëm censi, që pritet të publikohet në qershor.

Sipas Eurostat, në 2023 kanë qenë 9,145 shtetas shqiptarë që kanë aplikuar për azil në një nga shtetet e Bashkimit Europian, ose 331 aplikime për 100 mijë banorë, nga 17 aplikime për 100 mijë banorë, që është mesatarja e të gjithë aplikimeve në BE.

Të dhënat e Eurostat për aplikimet për azil nga të gjitha shtetet, të përpunuara nga Monitor në raport me popullsinë përkatëse tregojnë se Shqipëria ishte e treta në botë për aplikimet e larta për azil në raport me

SHQIPËRIA, E TRETA NË BOTË PËR APLIKIMET PËR AZIL NË 2023, NË RAPORT ME POPULLSINË

[Aplikimet për azil për 100 mijë banorë në BE, viti 2023]



popullsinë (shiko grafikun Aplikimet për azil për 100 mijë banorë në BE, viti 2023).

Në vend të parë është Siria, një shtet që prej vitesh po vuan pasojat e luftës civile. Ky shtet kishte 874 aplikime për 100 mijë banorë në vendet e BE-së në 2023. Sirianët i ikin luftës. Deri në dhjetor 2022, sipas vlerësimeve nga UNCHR kanë humbur jetën mbi 580,000 persona; 13 milionë sirianë janë zhvendosur dhe 6.7 milionë

refugjatë të detyruar të largohen nga Siria.

Shteti i dytë është Gjeorgjia, që kishte 668 aplikime për azil në BE për 100 mijë banorë. Gati gjysma e aplikimeve janë në Gjermani, të ndjekura nga Franca dhe Italia. Sipas mediave të huaja aplikimet janë kryesisht për arsye ekonomike, ndërsa në vitin 2023 ato ranë me 12%, kryesisht pasi Gjermania e futi Gjeorgjinë në listën e vendeve të sigurta dhe përsh-

pejtoi procedurat e depërtimit.

Maqedonia e Veriut ka parë vitet e fundit një rritje të emigrimit në raport me popullsinë, duke e renditur atë të katërtën në botë, pas Shqipërisë. Në 2023, sipas Eurostat aplikimet arritën rekordin e viteve të fundit, në 6760 të tilla.

Kosova u rendit e 12-a në botë, me 162 aplikime për 100 mijë banorë. Aplikimet për azil pritet të shtohen ndjeshëm këtë vit, pas heqjes së vizave me vendet e BE-së.

Serbia renditen në vendin e 21, me 68 aplikime për 100 mijë banorë, Mali i Zi me 58.1 (vendi i 25) dhe Bosnja e 48-a, me rreth 49 aplikime.

Në Shqipëri, të dhënat e Eurostat tregojnë se Franca vijon të jetë vendi më i preferuar për shqiptarët për të kërkuar azil, me 3530 aplikime, apo 38% të totalit në vitin 2023. Gjermania renditet e dyta, me 2225 aplikime apo 24% e totalit.

Një raport i fundit i Kombeve të bashkuara, që mat cilësinë e jetesës përmes indeksit të lumturisë gjeti se Shqipëria mbetet ndër shtetet më të palumtura në Europë, duke lënë pas vetëm Turqinë. Pikët e indeksit, që mat lumturinë u përkeqësuan në 2023. Vlerësimin më të ulët Shqipëria e

merr në treguesin e perceptimit të korrupsionit, me vetëm 0.049 pikë, ku pyetja kryesore që u bëhet të anketuarve lidhet me përhapjen e korrupsionit në qeveri. Vlerësim të dobët ka dhe bujaria me 0.138 pikë, që tregon që shqiptarët nuk e mbështesin dhe aq shumë njëri tjetrin.

Renditja është më e lartë tek të ardhurat për frymë, me 1.4 pikë, mbështetja sociale 0.9 pikë, pritisshmëria për një jetë të shëndetshme, 0.6 pikë. Shqiptarët mendojnë se nuk kanë shumë mundësi zgjedhjeje në jetë, me treguesin që merr 0.69 pikë.

Niveli i ulët i perceptuar i cilësisë së jetesës duket se është arsyeja kryesore se pse shqiptarët, sidomos të rinjtë, po vijnë të ikin nga vendi me ritme që krahasohen me shtetet që janë në luftë apo konflikte civile.

Gjallërimi i emigracionit vitet e fundit po shkakton deformime të mëdha në ekonominë e vendit, që nga disponueshmëria e fuqisë punëtore, që po pengon planet e bizneseve për zgjerime e investime, tkurrja e konsumit dhe në afatin e gjatë zhbalancimin e mëtejshëm të skemës së pensioneve. Monitor

SONILA MEÇO

PARA SE TË MAHNITENI ME TIRANËN E GJALLË

Mos përtoni të lexoni, para se të mahniteni me Tiranën e gjallë, të paktahesueshme me grinë e kryeqendrave rajonale!

Të duket se Shqipëria po bëhet lideri ballkanik me rol të rëndësishëm në krizat ndërkombëtare? Shumë mirë, tani merre vesh se:

“Më shumë se 80% e perimeve, frutave dhe zarzavateve në tregjet vendase të pakicës janë nga importi. Patatet dhe fasulet po vijnë nga Egjipti dhe Turqia, perimet dhe frutat nga Greqia, bulmetrat dhe drithërat nga Serbia, Ukraina, Maqedonia e Veriut.”

Të duket samiti BE-Ballkan Perëndimor në Tiranë arritje madhështore e qeverisë, që po vë në rresht rajonin? Tani merre vesh se: “Në vendin e parë përr importin e ushqimeve në sasi është Serbia, e cila eksportoi në Shqipëri 242 mijë tonë ushqime për vitin 2023, me një rritje vjetore prej 30%. Rritja më e madhe ishte në importin e drithërave, me rreth 30% dhe në fruta dhe arra, importet e të cilave shënuan rritje vjetore me 6000% më 2023. Vendi ynë importoi nga Serbia 1853 tonë fruta dhe arra, nga vetëm 30 tonë më 2021.

Rritje të madhe nga Serbia shënuan edhe importet e zarzavateve të përpunuara, të cilat arritën në 2200 tonë, me rritje vjetore 58%. importi i kafshëve të gjalla gjithashtu



shënoi rritje me 110%.”

Të duket mrekulli Tirana plot e përplot me turistë, jetë të gjallë e vibrim kryeqendre europiane? Tani merre vesh se:

“Sipas informacioneve që u siguruan nga

“Monitor”, tregjet e fshatarëve në bashkitë e Burrelit, Rrëshenit, Kukësit, Tropojës, Fushë-Arrësit-Pukës nuk ekzistojnë më, pasi nuk ka më prodhim.”

Të duket ndërtimi “magjia” e rritjes

ekonomike dhe mirëqenies tënde? Tani merre vesh se:

“Prodhimi i Brendshëm Bruto në bujqësi ra në tremujorin e tretë të vitit 2023 për të gjashtin tremujor radhazi, duke e bërë rënien të qëndrueshme në sektor.”

Të duket se qytetet po shndrijnë nga Rilindja Urbane? Tani merre vesh se:

“Çmimi i qepëve dhe patateve këtë vit ka shënuar rritje vjetore me mbi 21%, për shkak se prodhimi vendas është zëvendësuar me import. Kurse çmimi i bulmetit u rrit me rreth 40% dy vitet e fundit prej mungesës së qumështit.”

Të duket se Sazanin po e merr Kushner-i i Trump-it, Gjadrin e Lezhën Meloni dhe Durrësin arabët? Dhe kjo të lumturon për aftësitë udhëheqëse të liderit? Shumë mirë, por zamet ta dish edhe këtë:

“Vlera e drithërave të importuara ra me 24% më 2023, por çmimet në tregun e brendshëm u rritën me 5% në këtë grup që ka burim kryesor importin. Çmimet e importit, bulmetit dhe vezëve shënuan rënie vjetore me 12.2% në periudhën referuese, por çmimet në tregun e brendshëm u rritën 14.5% për këtë grup.”



Apollonia Transport

TRANSPORT MALLRASH ANGLI - SHQIPERI SHQIPERI - ANGLI



SHQIPËRI

Tiranë - Durres-Elbasan-Berat
Fier-Vlorë-Roskovec-Ballsh



BRITANI

Londër - Birmingham
Manchester - Leeds - Luton

NA KONTAKTONI

UK: 00447429200952

AL: 00355682948843

AL:00355694031009



TRANSPORT SHQIPERI - ANGLI

+44 7741 588799



+355 67 728 2828

SHQIPËRI

- Elbasan
- Tirane
- Shkoder
- Lezhe
- Laç
- Fushe Krujë
- Lushnjë
- Berat
- Poshnjë
- Belsh

ANGLI

- Londër
- Manchester
- Sheffield
- Leeds
- Birmingham
- Coventry
- Luton
- Oxford
- Northampton

Ju Faleminderit qe na besoni!

Për oferta speciale ju lutem na kontaktoni në çdo kohë

AKOMA NUK KENI WEBSITE?

Akoma nuk jeni të
regjistruar ne google?

Our Best Service

- ✓ Responsive Website
- ✓ Landing Page
- ✓ Redesign Website
- ✓ Web Development

ADRESA E ZYRAVE:

➤ **30 AVENONS ROAD
LONDON, E13 8HT**



020 7018 7929



073 4066 5946



078 5997 7545

JARED KUSHNER: ÇFARË PO PLANIFIKON DHËNDRI I TRUMPIT NË BALLKAN?

MICHAEL MARTENS

Një projekt i mundshëm investimi i dhëndrit të Donald Trumpit, Jared Kushner, në Serbi dhe në Shqipëri ka ndezur debate të gjalla, veçanërisht në Beograd. Të premtën, Kushner konfirmoi për New York Times planet, të cilat gazeta i përdori si bazë për një raport gjithëpërfshirës mbi projektin. Kjo shkaktoi reagime të qarta nga qeveria serbe gjatë fundjavës.


“New York Times” raportoi se në Beograd bëhet fjalë për ndërtimin e një hoteli dhe një godine me “1500 njësi banimi”, ndërsa në Shqipëri bëhet fjalë për ndërtimin e resorteve luksoze në bregdetin e Mesdheut. “Jemi shumë të emocionuar. Ne nuk i kemi bërë ende këto marrëveshje, kështu që ato mund të mos ndodhin, por ne kemi punuar shumë për to dhe jemi shumë afër”, citohet të ketë thënë Kushner nga gazeta.

Sipas raportit, në negociatat për marrëveshje ka marrë pjesë edhe ish-ambasadori i Trumpit në Gjermani dhe përfaqësuesi i tij për Ballkanin, Richard Grenell. Trump e kishte emëruar Grenellin si “të dërguar special të tij në negociatat paqesore ndërmjet Kosovës dhe Serbisë” në vitin 2019. Në atë kohë, Grenell krijoi kontakte të mira me kryeministrin shqiptar Edi Rama dhe me presidentin serb Aleksandar Vuçiq. Ai nuk e fsheh faktin se ka dashur t’i materializojë këto marrëdhënie pas largimit të tij nga politika: “Askush nuk duhet të kërkojë kurrë falje që dëshiron të fitojë para”, ka thënë Grenell, në një intervistë në Shqipëri mbi planet e tij në rajon.

Për Ramën dhe Vuçiqin, mbështetja e dëshirave të tilla mund të rezultojë e dobishme politikisht në qoftë se Trump bëhet përsëri president – veçanërisht nëse ai e merr Grenellin në ekipin e tij. Kur Grenell ishte i dërguar i Trumpit për Ballkanin, Rama, Vuçiq dhe më pas Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi ishin në prag të ndarjes së Kosovës nga këndvështrimi i Qeverisë së Kosovës. Sipas marrëveshjes së planifikuar asokohe e cila u banalizua si “shkëmbim terroresh”, veriu i Kosovës do t’i takonte Serbisë ndërsa jugu do t’i kthehej Shqipërisë.

Asokohe u parandalua një marrëveshje e rrezikshme

Po të arrihej atëherë kjo marrëveshje,



ajp mund të kishte shënuar fillimin e ndryshimeve të mëtejshme të rrezikshme të kufijve, të cilat ishin shkak kryesor i luftërave të përgjakshme ballkanike të viteve 1990. Por, kjo marrëveshje dështoi asokohe, jo vetëm për shkak të rezistencës së Gjermanisë dhe kancelares së saj Angela Merkel. Marrëdhëniet e mira me Presidentin e ardhshëm eventual të Shteteve të Bashkuara mund t’u hapin rrugë Ramës dhe Vuçiqit për të rinovuar planet e tyre të atëhershme.

Në planin e brendshëm, planet [e Kushnerit] ngjallin emocione në Serbi, sepse në fokus të projektit investiv është ndërtesa e ish-Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave, e cila ishte bombarduar gjatë sulmeve ajrore të NATO-s ndaj Serbisë, në 1999. Kjo është e vetmja ndërtesë e

madhe në Beograd që ishte shkatërruar atëherë që ka mbetur rrënoja. Në anën tjetër të rrugës gjenden Ministria e Punëve të Jashtme dhe ndërtesa e Qeverisë së Serbisë, kështu që rrënojat prej 50,000 metrash katror hapësirë të shfrytëzueshme janë një lokacion i shkëlqyeshëm. Kjo ndërtesë është ndërtesë e mbrojtur, por në pamjet e publikuara nga Kushneri shihet se ajo ka pak ngjashmëri me pamjen origjinale të ndërtesës.

Megjithatë, Qeveria serbe reagoi ashpër ndaj planeve të investimeve të promovuara nga Kushneri. Ministri i Infrastrukturës, Goran Vesiq, duke iu përgjigjur raportit të New York Times, këtë fundjavë, deklaroi se për projektin e pasurive të paluajtshme janë paraqitur disa aplikime. Por, deri më tani nuk është nënshkruar asnjë letër

qëllimi e lëre më ndonjë kontratë obliguese.

“Se a do të ndodhë kjo varet nga ajo se a mund të arrijmë një marrëveshje me partnerët e mundshëm. Në qoftë se nuk mund të biem dakord, nuk do të ketë kontratë”, citohet ministri nga mediet serbe. Nga ana tjetër, portalet pro-qeveritare tashmë e kanë promovuar projektin investiv dhe kanë raportuar me tone pozitive, gjë që sugjeron se më e rëndësishme është projekti të miratohet nga presidenti Vuçiq. Me pëlqimin e tij, nuk do të ishte më pengesë për investitorët çfarëdo kundërshtimi nga Enti për Mbrojtjen e Monumenteve, sepse organet e kontrollit të shtetit në Serbi janë vetëm fasadë, në qoftë se nuk përputhen me vullnetin e presidentit.

Një politikan opozitar serb kishte deklaruar më parë se Vesiq e kishte nënshkruar një memorandum ose së paku se ishte autorizuar nga qeveria për të nënshkruar një letër qëllimi, sipas së cilës një kompani amerikane e quajtur “Kushner Realty”, e regjistruar në Delaware dhe e themeluar në mars 2022, si edhe një kompani tjetër e quajtur “Atlantic Incubation Partners” janë lejuar të zhvillojnë prona në Beograd. Vesiq e hodhi poshtë këtë, por gjithashtu theksoi se, një çerek shekulli pas përfundimit të luftës, Qeveria e Serbisë nuk ka në plan të presë edhe 25 vjet të tjera për të shfrytëzuar pronat në një lokacion të shkëlqyeshëm.

(“Frankfurter Allgemeine Zeitung”)

INVESTIGIMI I "THE SUNDAY TIMES": SI PO PASTROHEN MILIARDAT E DROGËS ME NDËRTIME NË SHQIPËR

Numëron vinçat dhe kryeqyteti shqiptar duket sikur po lulëzon. Por miliardat "parash të pista" të dërguara nga bandat që kontrollojnë rrugët e drogës në Evropë, kanë bërë që horizonti të shkëlqejë, shkruan The Sunday Times.

Horizonti i kryeqytetit të Shqipërisë është si një deklaratë besimi. Në të gjithë Tiranën po ngrihen kulla të reja me shkëlqim, disa prej tyre të projektuar nga arkitektë me famë botërore. Në sheshin qendror "Skënderbej", blloqe zyrash gjigante dhe ndërtesa të shkëlqyera apartamentesh duken pas një xhamie të shekullit të 19-të. Më tej, Muzeu Historik Kombëtar duket i vogël me mozaikun e tij të madh socialisto-realist mbi dyert e hyrjes.

Por ky bum ndërtimi ka më shumë nga sa duket. Investigimet mbi krimin dhe ekonomistët kanë paralajmëruar se kjo tregon për një anë më të errët të ekonomisë së vendit, e nxitur nga baronët shqiptarë të drogës që anembanë globit sjellin në shtëpi më shumë se 1 miliard euro në vit për t'i pastruar përmes ndërtimit dhe pronave.

"Është e vështirë të llogaritet pastrimi i parave, por shpesh duhet vetëm të numëroni vinçat dhe Tirana është vendi për ta bërë këtë" – thotë Antonio Nicaso, një ekspert mbi mafian dhe autor librash. Paratë vijnë lumë nga Belgjika, Spanja, Holanda dhe Amerika e Jugut. Qindra miliona paund vijnë gjithashtu nga Britania e Madhe, sipas Agjencisë Kombëtare të Krimin të Britanisë. Kushdo që blen kokainë në Britani ka shumë të ngjarë të ndihmojë në shndërrimin e Tiranës në një Dubai në miniaturë.

Apartamente boshe dhe 1 miliard euro para droge

Sasia e parave të pista që qarkullojnë është marramendëse. Rreth 3.7 miliardë euro në vit investohen për ndërtim dhe prona, sipas Ola Xamës, një gazetare investigative biznesi që ka punuar me Transparency International. Kjo është 15% e PBB-së. Xama thotë se nga kjo shumë, vetëm 847 milionë euro kalojnë në sistemin bankar.

"Kjo do të thotë se 2.85 miliardë euro janë para të pista, madje edhe duke llogaritur remitancat nga emigrantët dhe faktin që Shqipëria është një ekonomi parash cash, unë vlerësoj se 1.3 miliardë euro janë para droge" – thotë Xama.

Paratë e pista kanë rritur kërkesën për prona në Tiranë, me çmimet e apartamenteve që u rritën nga 1000 euro për metër katror që ishin në vitin 2017 në rreth 4000 euro sot. Oferta tashmë tejkalon kërkesën dhe shumë banesa mbeten të pashitura, megjithatë çmimet nuk tregojnë shenja rënieje. Paratë nuk përdoren vetëm në blerjen e banesave, por edhe në blerjen e kompanive që i ndërtojnë ato, thotë Belind Këlliçi, anëtar i Partisë



Demokratike të opozitës në Shqipëri, i cili bëri një fushatë kundër pastrimit të parave kur kandidoi për kryetar bashkie të Tiranës vitin e kaluar.

"Kjo është arsyeja pse ka kompani që marrin leje për të ndërtuar ndërtesa me vlerë dhjetëra milionë euro të cilat kanë vetëm një kapital të deklaruar prej 1000€" – tha ai. "Tirana kishte 8000 apartamente bosh në vitin 2015. Që atëherë janë dhënë leje për 10 milionë metra katrorë ndërtim dhe tani kemi 40 000 apartamente bosh. Megjithatë çmimet po rriten dhe një çifti mesatar tani i duhen 64 jetë për të kursyer për të blerë një apartament të vogël."

Si e morën bandat shqiptare kontrollin e trafikut të kokainës

Jashtë selisë së partisë së tij, Këlliçi shikon kullën më të fundit dhe më të lartë të Shqipërisë që po përfundonte: "Downtown One", 37-katëshe, e cila ka një fasadë që imiton hartën e Shqipërisë. Parkingu nëntokësor i kullës u hap nga një nënkontraktor lokal, "Alesio 2014", i cili ka pasur një rol në shumë ndërtesa të reja në qytet dhe mburret se ka një sipërmarrje të përbashkët me arkën e shtetit shqiptar. Dhe këtu vjen surpriza, pronari Anton Gjinaj, u arrestua me një urdhërarrestimi spanjoll në vitin 2021 për kontrabandë heroine me vlerë 1.9 milionë euro nga Holanda në Spanjë fshehur në gomat e makinave.

Paratë që vërshojnë në Shqipëri janë falë suksesit të jashtëzakonshëm të bandave të drogës në vend, që daton në vitet 1990. Vendi i varfër po dilte nga komunizmi dhe kontrabandistët panë shansin e tyre për t'i shitur kallashnikovët "mafias Ndrangheta" të Italisë. "Ndrangheta e kuptoi se mund t'u besonte shqiptarëve, i prezantoi ata me kartelat në Kolumbi dhe Ekuador dhe doli garant për ta" – thotë Nicaso.

Në shkurt, Europol tha se kishte shkatërruar një linjë droge përmes Ekuadorit në Europë, e cila ishte ideuar nga një shqiptar i cili kishte një marrëveshje me kultivuesit kolumbianë për të marrë 4 ton kokainë në muaj, për t'u transportuar të fshehura në kuti bananesh. Operacione të tilla nuk janë të pazakonta. Ndërkohë, të rinjtë që kultivonin plantacione masive të kanabisit në Shqipëri, shpesh largohen jashtë vendit kur policia nuk i lë për t'u bërë ushtarë të bandave.

"Papritmas shqiptarët u përfshinë në të gjithë rrugën e kokainës për në Europë, nga prodhuesi, te rruga dhe pranonin të merrnin fitime më të ulëta. Ata mund të ofronin 1 kilogram kokainë 99% të pastër në Londër për 4000 – 6000 paund ndërsa holandezët kërkonin 20 000 paund" – thotë Nicaso.

Europol publikoi muajin e kaluar videon e kapjes së një sasie kokaine dhe parash që lidheshin me një shqiptar me banim në Ekuador. Ndryshe nga 'Ndrangheta, që i fsheh paratë e

saj jashtë vendit dhe e lë Kalabrinë e saj të zhytur në varfëri, bandat shqiptare shpesh preferojnë t'i dërgojnë fitimet e tyre në shtëpi për të përfutur nga çeçet e lehta dhe ekonomia e parave të thata.

"Grupet shqiptare të krimin të organizuar kanë akses të konsiderueshëm në tregun e trafikut të drogës në Mbretërinë e Bashkuar, i cili është ende një biznes me para të thata", – thotë Pete Stevens, zëvendës drejtor i Agjencisë Kombëtare të Krimin. "Ata janë në përgjithësi shumë të shpejtë për të transferuar në Shqipëri të ardhurat e tyre nga paratë e krimin, për investime ose për t'i fshehur ato në mënyrë të sigurt nga autoritetet."

Klodiana Lala, një gazetare shqiptare për krimin thotë: "Bandat shqiptare të drogës me bazë në Mbretërinë e Bashkuar po i investojnë paratë e tyre në ndërtim dhe biznese të tjera në Shqipëri. Ata mblidheshin, merrnin furgona me qira dhe i dërgonin në shtëpi plot me para, ose përdornin kamionë që transportonin makina dhe fshihnin paratë në makina, por tani kriptomonedhat kanë ndryshuar gjithçka dhe po i përdorin të gjithë."

Vjet 436 milionë sterlina u dërguan në Shqipëri, nga 250 milionë sterlina në vitin 2019. "Është e qartë se po ndodh diçka", – thotë Ola Xama, e cila përlogaritit shifrat. Ajo zbuloi se në vitin 2022, 368 milionë paundë përfunduan në Shqipëri pa kaluar përmes bankave.

Paratë e pista kanë hyrë si në

ekonominë shqiptare ashtu edhe në politikën e saj, pasi baronët e drogës blejnë vota për 50 euro në emër të politikanëve miq. Qeveria shqiptare ka reaguar duke ngritur një prokurori të posaçme të quajtur SPAK, me zyrtarë të trajnuar nga FBI-ja në Virxhinia.

Aktualisht duket se kjo ka pasur një efekt. Në vitin 2022, SPAK ngriu asetet e lidhura me Gjinajn, manjati i ndërtimit, nënkontraktori pjellor i të cilit hapi parkingun e makinave për "Downtown One". Ata ngritën dyshime se pasuria e tij e pazakontë ishte e lidhur me trafikun e drogës.

SPAK tani është në pritje të një vendimi gjykatë për konfiskimin e pasurive të tij. Mes tyre është kompania që qëndron pas ndërtimit të "Garden Residence Turdiu", një kompleks i ri pallatesh në Tiranë ku jeta vazhdon normalisht. "Unë nuk do ta kisha blerë banesën time nëse do ta dija se do të sekuestrohej nga qeveria" – thotë Fatjona, 40 vjeçe, një banore që shihte fëmijët e saj duke luajtur. Një zëdhënës i kompanisë "Alesio 2014" tha: "Është një çështje që po vazhdon në gjykatë dhe do të sqarohet së shpejti."

Përgjatë bregdetit, ku paratë po pastrohen përmes "furtunës" së hoteleve të reja që ofrojnë shërbime për turistët që zbulojnë plazhet shqiptare, qeveria po përpiqet të tregojë se po i lufton bandat. Në janar, ministri i brendshëm, Taulant Balla, njoftoi se një hotel me pamje mahnitëse nga deti, i sekuestruar nga kriminelët në Vlorë, do të përdorej nga oficerët e policisë për pushime. Pëllumb Gjoka, një biznesmen i quajtur dikur një "investitor strategjik" nga qeveria shqiptare pasi ka marrë miratimin për të ndërtuar një resort 52 milionë euro në bregdet, u arrestua nga SPAK-u vjet me dyshimin se kishte porositur vrasje mafioze.

Por teksa koha fluturon për autoritetet që përpiqen të ndalojnë fluksin e parave kriminale: rreziku i një flluske ndërtimesh po rritet, dhe bashkë me të edhe potenciali për shkatërrim në ekonomi.

"Sektori i ndërtimit është rritur shumë më shpejt se ekonomia gjatë 3 viteve të fundit" – thotë ekonomisti Klodian Tomorri. "Tirana tani po ndërton rreth 300 m2 sipërfaqe për çdo banor të ri. Kjo është 9 herë më shumë se mesatarja e BE-së. Të gjitha këto rritin shanset për një flluskë. Nëse pasojat shpërthejnë, kreditë me probleme do të rriten, firmat e ndërtimit do të falimentojnë, pronarët e shtëpive do të humbasin investimet dhe do të ketë një recesion të mundshëm. Të shohim se ç'do të ndodhë". /Lapsi.al

MERCY FUNERAL SERVICES

88-90 Carlton Vale, London NW6 5DA. Tel:020 8127 5565 M:07915 339870
info@mercyfuneralservices.co.uk www.mercyfuneralservices.co.uk



project of UK ALBANIAN MUSLIM COMMUNITY & CULTURAL CENTRE

Ata, të cilët kur i godet ndonjë fatkeqësi thonë: "Me të vërtetë, Ne jemi të All-llahut dhe ne vetëm te Ai kthehem!" Të tillë janë ata që kanë bekime prej Zotit të tyre dhe mëshirë dhe të tillë janë ata të udhëzuarit. (Sure El-Bekare 156-157)

Rreth Nesh

Komuniteti Mysliman Shqiptar dhe Qendra Kulturore e MB (e njohur më parë si Qendra Islamike e Kosovës) u formua dhe themelua në vitin 1994 në Londër, nga Zymer Salih, Syed Mohammad Tanzeem Wasti dhe Bahri Bojaj. Shërbente për të përmbushur nevojat fetare, arsimore, sociale dhe kulturore të Komunitetit pas konfliktit në Ballkan dhe gjenocidit në Kosovë. Në vitin 2009, organizata arriti të blinte ndërtesën aktuale të xhamisë. Në vitin 2020 xhamia u zgjerua për të përfshirë shërbime funerale për komunitetin mysliman.

Mercy Funeral Service

Kemi kënaqësinë t'ju njoftojmë hapjen e 'Mercy Funeral Services' si një projekt i Komunitetit Mysliman Shqiptar dhe Qendrës Kulturore në Mbetrin e Bashkuar.

Pakoja jonë përfshin

- Këshilla për të gjithë organizimin praktik për të ndjerin
- Kujdes dhe këshillim për familjaret e pikëlluar
- Funerale në MB, përfshirë transportin
- Riatdhesim në vendet e rajonit të Ballkanit dhe në mbarë botën
- Unik, Shërbimi Islamik funerali për ju dhe familjen tuaj

Këshilla

Në momentin e humbjes, sipas rrethanave të secilit individ, ne ofrojmë këshilla të menjëhershme në lidhje me hapat e nevojshëm për të regjistruar një vdekje dhe për të filluar përgatitjet funebre, në përputhje me kërkesat e familjes. Ne do t'ju udhëzojmë përgjatë kësaj kohe shumë të vështirë dhe do të ndërliqemi si përfaqësuesi juaj me autoritetet përkatëse

Ne sigurisht do t'ju provojmë duke ju munduar me frikë, uri, humbje të pronave, jetëve dhe fryteve. Lajmëroni pra, durimtarët; (2:155)

Kujdesi dhe përgatitjet

Në momentin e parë më të përshtatshëm, ne do ta sjellim të ndjerin në morgun e xhamisë sonë, ku stafi ynë i përkushtuar dhe me përvojë, do të organizojë të gjitha përgatitjet e nevojshme sipas rregullave fetare.

Ne do të diskutojmë me ju dhe do të organizojmë lutjen e xhenazes, zakonisht në xhaminë tonë, përpara zhvendosjes në banesën e fundit të zgjedhur prej jush. Ne gjithashtu do të diskutojmë transportimin e të ndjerit në vendin e riatdhesimit nëse është e nevojshme.

Konsultim

Sado të përgatitur të jemi për humbjen e të dashurve tanë, këto janë momente që kërkojnë këshillim dhe ndjeshmëri të veçantë. Ne përlësisht ju ofrojmë mbështetjen tonë dhe këshillim në ambjentet e xhamisë nga hoxhallarët tanë.

Mbulimi i Kostove

Si plotësues i shërbimeve tona funerale, ne bashkëpunojmë me organizata të ndryshme në MB. Një nga organizatat me të cilat ne punojmë ngushtë është Komuniteti Islamik Milli Gorus dhe shërbimi i tyre i ndihmës funebre, UQBAH. UQBAH është një organizatë bamirëse me qendër në MB e cila siguron ndihmë financiare për myslimanët në rast vdekjeje dhe siguron shpenzimet e funeralit në MB dhe kostot e riatdhesimit në vendin përkatës deri në një maksimum prej 4000 £, me një tarifë vjetore prej afërsisht 80.00 £ në vit, për familje. Ky fond shfrytëzohet vetëm për të mbuluar kostot e varrimit dhe kontributet e anëtarësimit tuaj, përdoren si një bamirësi për të mbështetur anëtarët e tjerë kur lind nevoja.

Kostot e shërbimeve funerale

- Shërbimet funerale dhe parcelat e varrimit në MB kanë një tarifë fillestare prej afërsisht 4500 £ e lartë
- Kostot e riatdhesimit janë afërsisht 3000 £

Duke u bashkuar me UQBAH, ju dhe familja juaj do të gjeni qetësinë e mëndjes dhe shpirtit, duke ditur që e keni gjithçka të organizuar. Ky fond është në dispozicion për varrimin në MB dhe riatdhesim deri në aeroportin e vendit të riatdhesimit.

Brenda termave dhe kushteve të anëtarësimit në UQBAH, çdo kursim shtesë gjatë riatdhesimit mund të përdoret për koston e një bilete fluturimi për një anëtar shoqëruar të familjes.

Çdo tarifë shtesë e vendosur nga Mercy Funeral Service, e cila nuk mbulohet nga skema e UQBAH, duhet të paguhet nga familja e të ndjerit. Nëse nuk keni anëtarësim në një skemë si UQBAH, të gjitha shërbimet funerale dhe kostot e varrimit, do të duhet të paguhet tërësisht nga familja e të ndjerit..

Për t'ju regjistruar dhe për anëtarësim në UQBAH, ju lutemi vizitoni linkun
<https://www.uqbah.org.uk/online-registration/>

Formularët e anëtarësimit në UQBAH mund të merren edhe direkt nga zyrat tona.

Na kontaktoni:

Telefon:0208 1275565/07915339870

Adresa elektronike/Email: info@mercyfuneralservices.co.uk

Faqja e internetit/Website: www.mercyfuneralservices.co.uk

Profeti Muhamed paqja dhe bekimi qofshin mbi të ka thënë:

Allahu i Lartësuar thotë: Unë nuk kam asgjë për t'i dhënë robit tim besnik, nëse bëj që shoku i tij i dashur të vdesë dhe ai tregohet i durueshëm, përveç Xhenetit.

Xhamia e Shqiptarëve në Londër

UK Albanian Muslim Community & Cultural Centre

88- 90 Carlton Vale, London NW6 5DA Tel: 020 7625 5789

Charity Reg No: 1057193, Company No: 3228543

Web: www.xhemiaeshqiptareve.org.uk, www.ukamccc.co.uk Email: info@ukamccc.co.uk



Vaktija e Ramazanit 2024

Dita e Ramazanit	Data	Dita	Sabahu/ Syfyri	Lindja e Diellit	Dreka	Iqindia	Akshami / Iftari	Jacia/ Taravia
1*	11	H	04:43	05:03	12:16	03:17	06:02	07:24
2	12	Ma	04:41	05:01	12:15	03:18	06:04	07:26
3	13	Mr	04:38	04:58	12:15	03:19	06:06	07:27
4	14	E	04:36	04:56	12:15	03:20	06:07	07:28
5	15	P	04:34	04:54	12:14	03:21	06:09	07:30
6	16	S	04:32	04:52	12:14	03:22	06:11	07:32
7	17	D	04:29	04:49	12:14	03:24	06:12	07:32
8	18	H	04:27	04:47	12:14	03:25	06:14	07:34
9	19	Ma	04:25	04:45	12:13	03:26	06:16	07:36
10	20	Mr	04:23	04:43	12:13	03:27	06:18	07:38
11	21	E	04:21	04:41	12:13	03:28	06:19	07:38
12	22	P	04:20	04:40	12:12	03:29	06:21	07:40
13	23	S	04:18	04:38	12:12	03:30	06:23	07:42
14	24	D	04:15	04:35	12:12	03:31	06:24	07:43
15	25	H	04:13	04:33	12:11	03:32	06:26	07:44
16	26	Ma	04:12	04:32	12:11	03:33	06:28	07:46
17	27	Mr	04:09	04:29	12:11	03:33	06:29	07:47
18	28	E	04:08	04:28	12:11	03:34	06:31	07:49
19	29	P	04:06	04:26	12:10	03:35	06:33	07:50
20	30	S	04:04	04:24	12:10	03:36	06:34	07:51
21	31	D	05:02	05:22	01:10	04:37	07:36	08:53
22	1	H	05:00	05:20	01:09	04:38	07:38	08:55
23	2	Ma	04:58	05:18	01:09	04:39	07:39	08:56
24	3	Mr	04:56	05:16	01:09	04:40	07:41	08:57
25	4	E	04:53	05:13	01:08	04:41	07:43	08:59
26	5	P	04:51	05:11	01:08	04:42	07:44	09:00
27	6	S	04:49	05:09	01:08	04:42	07:46	09:02
28	7	D	04:47	05:07	01:08	04:43	07:48	09:04
29	8	H	04:44	05:04	01:07	04:44	07:49	09:05
30*	9	Ma	04:42	05:02	01:07	04:45	07:51	09:06

Duaja e fillimit të agjërimit
Vendosa të agjëroj nesër për hirë të Allahut të lartësuar.

Duaja e përfundimit të agjërimit
O Allah! Për Ty agjërova, Ty të besoj, në Ty mbështetem dhe me begatin tuaj iftar bëj.

Duaja e natës së Kadrit
O Allah ti je falës, Ti e do faljen, më fal mua.
O Allah më fal, më udhëzo, më jep furnizim dhe shëndet të mirë.

Data me rëndësi
11 Mars: Dita e parë e Ramazanit
27 Mars: Beteja e Bedrit
30 Mars: Qlirimi i Mekës, Itikafi
05 Prill: Nata e Kadrit
10 Prill: Dita e parë e Bajramit

Fondi i Xhamisë
UK Albanian Muslim Community and Cultural Centre
HSBC Bank
SC: 40-04-04 AC: 01665979

* **Zeqati i pasurisë**
(2.5% e kursimeve vjetore)
* **Sadakat-ul-Fitr**
(£5 në emër tuaj dhe anëtarëve të familjes)
* **Sadaka**
* **Fidje:** Nëse një person nuk është në gjendje të agjërojë për shkak të sëmundjes kronike ose pleqërisë, atëherë ai/ajo duhet të paguajë fidje £5, kjo është për të ushqyer një person të varfër çdo ditë të pa-agjëruar gjatë gjithë muajit të Ramazanit, ose duke dhënë 30 iftare të gjithë së bashku.
* UK Albanian Muslim Relief
HSBC Bank
SC: 40-42-08 AC: 62468719

Shërbimi i Xhenazës
T: 02081275565, M: 07915339870
Mercy Funeral Services
HSBC Bank
SC: 40-42-08 AC: 62468727

Profeti Muhamed ﷺ ka thënë "Bëhuni mëshirues ndaj atyre që janë në tokë, që t'iu mëshiroj Ai që është mbi qiej." Al-Termidhi 1924

* Namazi i fiter Bajramit është me 10/04/24 do të jenë sic vijon:

1. Hytbeja e parë do të jetë në gjuhën Shqipe, do të fillojë në orën 6:30 deri në orën 7:30.
2. Hytbeja e dytë në Arabisht-Anglisht, do të fillojë në orën 8:00 deri në orën 9:00.
3. Hytbeja e tretë në Arabisht-Anglisht, do të fillojë në orën 9:00 deri në orën 10:00.

* Për më shumë informacion në lidhje me faljen e namazit të Bajramit ose Shërbimet e xhenazave, ju lutemi na kontaktoni në detajet e dhëna më lart.

Rusia po i shfrytëzon tensionet etnike derisa Serbia po e kërcënon me dhunë Kosovën dhe secesionistët po e kërcënojnë me kolaps Bosnjën.

Nga Ivana Stradner dhe Mark Montgomery / The Wall Street Journal

Derisa të gjithë i kanë drejtuar sytë kah Ukraina, në Evropë po shpërthen një tjetër konflikt. Tri dekada pas shpërbërjes së përgjakshme të Jugosllavisë, përplasjet e fundit midis Serbisë dhe Kosovës kanë rindezur konfliktet e vazhdueshme etnike. Teksa Serbia nxit ngjarjet në terren, Moskë po ia vë flakën.

Vladimir Putini ka qenë i sinqertë në dëshirën e tij për ta dobësuar Organizatën e Traktatit të Atlantikut të Veriut dhe për ta rikthyer Rusinë në kufijtë e saj historikë. Por, me forcat ruse që po pësojnë humbje në Ukrainë, Moskë mund të fitojë shumë duke nxitur problemet në ndonjë vend tjetër të kontinentit. Një krizë e qëlluara racionale do t'ia krijonte Kremlinit mundësinë të ushtrojë ndikimin lokal përmes tregtisë së armëve dhe ndërmjetësimit, duke e larguar kështu vëmendjen nga Ukraina dhe duke i mundësuar Rusisë të ketë ndikim mbi udhëheqësit perëndimorë.

Ballkani Perëndimor është kandidat i përsosur. Kosova dhe Bosnja e Hercegovina nuk janë anëtare të NATO-s. Ashtu sikurse Moskë kërkon ta dominojë atë që ajo e quan "bota ruse", Serbia ka kohë që bën thirrje për të bashkuar "botën serbe". Në vitin 1998, ky koncept e nxiti Serbinë ta in-

PUTINI DËSHIRON LUFTË NË BALLKAN



vadonte Kosovën – konflikt ky që përfundoi vetëm me ndërhyrjen ushtarake të NATO-s në mars 1999, për t'u dhënë fund shkeljeve të drejtave të njeriut ndaj popullsisë etnike shqiptare nga Serbia.

Megjithëse mijëra ushtarë të NATO-s mbeten ende në Kosovë si paqeruajtës, tensionet atje mbeten të larta. Në vitin 2008, Kosova e shpalli pavarësinë e saj nga Serbia në mënyrë të njëanshme dhe mori njohje nga shumë vende perëndimore, përfshirë SHBA-në, por Serbia nuk e njeh ende sovranitetin e saj. Presidenti serb, Aleksandar Vučić, po e forcon kontrollin e tij mbi pushtetin në vend dhe gjatë vitit të kaluar, me mbështetjen ruse, ushtroi presion ndaj Kosovës.

Në muajin maj Serbia i vendosi trupat e saj ushtarake në gjendje të gatishmërisë luftarake, pas përlëshjes midis rebelëve etnikë serbë dhe paqeruajtësve ndërkombëtarë ku u plagosën 90 ushtarë të NATO-s. Ishte ky një veprim kremlinesk, që i përdor ten-

sionet etnike si pretekst për lëvizje ushtarake. Në muajin shtator, z. Vučić e kopjoi një faqe tjetër të librit të Putinit. Tridhjetë serbë etnikë, të armatosur rëndë, për të cilët Kosova thotë se ishin të pajisur nga Serbia dhe të lidhur me z. Vučić, e sulmuan një patrullë të policisë në Kosovë duke i lënë katër të vdekur. Presidenti serb mohoi t'i ketë armatosur sulmuesit.

Serbia e përdori incidentin si pretekst për të grumbulluar armë të rënda dhe trupa në kufirin me Kosovën, në fund të muajit shtator. Shtëpia e Bardhë ishte "shumë e shqetësuar se Serbia mund të përgatitej për të nisur pushtimin ushtarak", tha më vonë një zyrtar amerikan për revistën "Time". Një konflikt i tillë mund të përhapet lehtësisht edhe në Maqedoninë e Veriut fqinje, e cila është anëtare e NATO-s. Shqetësimi lidhur me krizën e krijuar e shtyu Uashingtonin të lëshonte informata të deklasifikuara të inteligjencës në lidhje me ngritjen e gatishmërisë ushtarake të Serbisë dhe me sulmin ndaj policisë së Kosovës.

Disa ditë më vonë, Serbia u tërhoq nga kufiri, por është e qartë se Beogradi dhe Moskë po përgatisin një fushatë të dytë dhune dhe provokimi në vitin 2024. Rusia po kryen operacione të ndikimit me mesazhe pro luftës në Serbi dhe po dërgon armë. Edhe Kina po dërgon armë. Serbia është zotuar të rrisë shpenzimet ushtarake këtë vit dhe vazhdon të mbajë një qendër të ashtuquajtur humanitare, të drejtuar nga Rusia, afër bazës kryesore të NATO-s në Kosovë e për të cilën zyrtarët perëndimorë thonë se shërben si qendër ruse e spinimit. Serbia dhe Rusia e mohojnë këtë. Serbët duket se janë të etur për një pretekst për të vepruar. Në muajin shkurt, Serbia tha se ndalimi i përdorimit të dinarit serb si valutë në Kosovë ka qëllim spastrimin etnik nga serbët.

Por, kjo nuk është e vetmja fuçi baruti në rajon. Bosnja e Hercegovina është gjithashtu në prag të kolapsit. Në fund të vitit të kaluar, udhëheqësi i serbëve të Bosnjës, Milorad Dodik – një tjetër aleat i Rusisë – kërcënoi se rajoni i tij gjysmëautonom, Republika Srpska, do të shpërbëhej nga vendi. Në muajt e ardhshëm, kjo mund ta rindezë dhunën etnike që i vrau më shumë se 100 mijë njerëz gjatë Luftës në Bosnjë, më 1992-1995.

Në një raport të 5 shkurtit, Zyra e Drejtorit të Inteligjencës Kombëtare të SHBA-së tha se në vitin 2024 pret një rrezik të madh të shpërthimit të dhunës ndëretnike në Ballkanin Perëndimor. Sekretari i Përgjithshëm

i NATO-s, Jens Stoltenberg, paralajmëroi në fund të vitit të kaluar se Rusia ka plane për ta destabilizuar Ballkanin, shqetësim ky të cilit i bëri jehonë ministri i Jashtëm britanik, David Cameron, në janar.

Fuqitë perëndimore duhet të parandalojnë paqëndrueshmërinë e mëtejshme në Ballkan. NATO-ja duhet të rifokusojë burimet ushtarake dhe diplomatike atje dhe të përforcojë angazhimet ushtarake në Kosovë. Një koalicion i anëtarëve të NATO-s të gatshëm tani duhet të angazhohet publikisht për të ofruar ndihmë ushtarake, nëse Serbia ose Rusia ndërmarrin hapa agresivë në Ballkan.

Ndërkaq, SHBA-ja duhet të vazhdojë të vendosë sanksione ndaj zyrtarëve që e minojnë sigurinë në Ballkanin Perëndimor dhe Bashkimi Evropian duhet t'i bashkohet. Gjithashtu, Uashingtoni dhe aleatët e tij duhet të vazhdojnë të përdorin inteligjencën e deklasifikuar për të mbështetur diplomacinë e tyre. Ndërsa NATO-ja duhet të angazhojë ekipe kundër luftës hibride, për të luftuar fushatat propagandistike ruse dhe serbe, si edhe për të forcuar sigurinë kibernetike.

Ndërsa NATO e feston 75-vjetorin e vet dhe z. Putin pëson më shumë humbje në Ukrainë, Moskë po përpjet të hapë një front të ri në Ballkan. Moskë nuk ka nevojë ta dërgojë ushtrinë e vet në rajon. Rusisë i duhet vetëm të mbështetet të Serbia për të nxitur dhunën dhe destabilitetin, duke llogaritur se NATO-ja do të ngurrojë.

PASTRIMIN E PARAVE E BËJNË PASTRUESËT

LUTFI DERVISHI

Një ngjarje që do të hyjë në analet e historisë si "Gjyqi i Shekullit", ndodhi sot në Tiranë.

R. D, e njohur ndryshe si "Mbretëresha e Korrupsionit në Shqipëri", me profesion pastruese, u dënua me 7 vite burg, zbritur në 4.8 vite falë gjyqimit të shkurtuar, pasi u zbulua si "truri" pas vjedhjes së 462 mijë eurove. Ish-drejtoresha, në shtëpinë e së cilës ra gjëma, u dënua me 1 vit e tetë muaj. Ky vendim ka shkaktuar një valë të shpejtë dhe të fortë reagimesh.

Ekspertë të drejtësisë dhe konsulentët antikorrupsion e quajnë vendimi një "fitore të madhe" kundër korrupsionit dhe një shembull i qartë se kulturës së pandëshkueshmërisë po i vjen fundi. "Më në fund, sistemi ynë gjyqësor ka

arritur të zbulojë dhe të dënojë aktorët e vërtetë të këtij tumori malinj për shoqërinë," tha një deputet i komisionit të sigurisë në Parlament.

"Është krejt e qartë që ajo kova që duhej mbushur me ujë për të larë dyshtemenë është përdorur për ta mbushur me lekë dhe euro - çka tregon se korrupsioni ekziston, tha një analist pranë të cilit është qeveria, duke shtuar se deri më tani ne thjesht kemi hedhur vështrimin gabim. Nuk duhet të shohim lart, por duhet të ulim kokën dhe të pranojmë, pse jo me përunjësi, se korrupsioni i vërtetë bëhet poshtë, nën hundën tonë, në këmbët tona. Pra, e thënë në mënyrë metaforike, nuk është ariu, por miu". "E kemi nisur vettingun së prapthi-tha një tjetër komentator, që mendon se në këtë vend nuk ka shpresë nëse nuk ndryshon opozita.

"Pastrueset duhet të futen në vetting dhe me radhë gjithë të tjerët, rojet, infermieret kamarierët... Kemi shpen-



zuar kot shumë kohë dhe energji me vettingun e policisë, gjyqësorit dhe politikës. Pastrimi duhet të nisë nga pastrueset.

"Armiku më i rrezikshëm është ai që

harrohet. Nuk paska qenë çështje sistemi, por këndvështrimi" - tha një polikan i shumicës. "Agjentët e policisë, hetuesit, BKH, SPAK dhe prokurorët e tjerë duhet të hapin sytë dhe të

shohin se gjakderdhja e vërtetë financiare këtij vendi po i vjen nga një armatë e pangopur pastruesish.

Tashmë e kemi të qartë se pastrimin e parave e bëjnë pastrueset. Përndryshe do të quhej "ministrim parash", "drejtim parash", prandaj quhet pastrim parash, për shkak të pastrueseve.

OSBE nga ana e vet, në një komunikatë për shtyp, përsëriti zhvillimin më të fundit dhe shtoi se vendimi i sotëm, megjithëse i pritshëm ka tronditur themelet e korrupsionit institucional në nivel global. Është një vendim i ri shokues sepse ka hedhur dritë mbi aktorët e vërtetë të korrupsionit dhe Shqipëria edhe në këtë drejtim po tregon aftësi të larta lidhësi".

Pas këtij vendimi pritet që renditja e Shqipërisë në indexin antikorrupsion të pësojë një ngjitje të menjëhershme dhe të lëre pas plot 192 vende e terri-tore.



KLINIKA SIDA ESHTË PËR SHITJE

Ne nje nga zonat me te pupulluara ne Southgate

E hapurt prej vitesh dhe me klientele te garantuar

Siperfaqe e konsiderueshme


Mundesi fantastike per zhvillimin e biznesit

Çmimi i arsyeshëm

Për më shumë info ju lutem kontaktoni

Tel: 020 8886 1888

Mob: 07887 246454



ZENEL KUÇANA

NJË ÇERЕК SHEKULLI NGA FUSHATA AJRORE E NATO-S

Nuk është fort e lehtë të meditosh pas një çerek shekulli, nga momenti kur u shpërfill momenti historik, tejet i jashtëzakonshëm për kombin shqiptar, gati-gati i pabesueshëm për shumë e shumë breza.

Aspak e lehtë nuk është, të rezonosh mes ditarit të Ollbrajt apo Wesley Clark, mes shumë e shume librash e kërkimesh, fjalimesh e përmbajtjes së dokumenteve që marrin herë-herë rëndësi të jashtëzakonshme, për të shënjuar thujse çdo moment sado të vogël, të parëndësishëm të momentit, për të krijuar tabllonë e madhe të çastit final, e pranverës që do të sillte lirinë e Kosovës.

Mbase shumëkujt u kujtohen ecejakjet që dukeshin të pafundme, të kërcënimeve të drejtpërdrejta të perëndimit për Millosheviçin, të ultimatumave të njëpasnjëshme.

Në një takim në Beograd me 22 mars Holbrookeu e ndërmoi një përpjekje të fundit për ta bindur Millosheviçin që ta shmangë luftën. Millosheviçi mospërfillës e hodhi poshtë thirrjen e Holbrookeut.

Ambasadori Miles e mbylli ambasaden e SHBA-së në Beograd dhe u largue prej këtij vendi me 23 mars. “Më thirri sekretari i përgjithshëm Solana për të ma përcjellë vendimin “Wes ke urdhërin ekzekutiv për fazen e pare të fushatës ajrore”.

Kur arrita në zyrën time të mërkurën në mëngjes urdhëri për ekzekutim kishte aritur dhe mbante datën 23 mars 1999. Uashingtoni më thirrën në orën 17:31. Ishte Hugh Sheltoni i cili përcolli urdhërin përfundimtar për ekzekutim, urdhër ky i autoriteteve amerikane të Komandës Kombëtare. “Wes”, tha ai “ke urdhër – nisja !”

(TË BËSH LUFTË MODERNE GJENERAL WESLEY K. CLARK ISH – KOMANDANT SUPREM I NATO-S fq. 220,227)

Fillimi i fushatës ajrore ishte preludi i përpjekjeve dhe luftës së paepur të popullit shqiptar të Kosovës për liri e pavarësi. Pas shpërbërjes së Jugosllavisë nuk do të ishte e mundur që populli shqiptar i Kosovës të qëndronte nën ombrellën e sundimit të Serbisë, prandaj që heret filluan përgatitjet për çlirimin e Kosovës, duke përgatitur oficerë, kuadro drejtues për këtë qëllim dhe kjo përgatitje filloj në Tiranë ku u përgatiten e trajnuan dhjetra kudro, që nga Adem Jashari me shokë.

Me patjetër që në memorjen e kombit janë regjistruar edhe momentet e 28 Nëntorit 1997, kur në fshatin Llaushë të Skënderajt Rexhep Selimi anëtar i shtabit të përgjithshëm të UÇK-së, i shoqëruar nga Mujë Krasniqi (kapuçi) dhe Daut Haradinaj (Davidi), me vendim politik të shtabit të përgjithshëm të UÇK-së, kanë qënë të parët që kanë dalë për herë të parë publikisht para opinionit publik në varrimin e mësuesit të shkollës së Llaushës Halitet Geci, ushtarë i UÇK-së vrarë dy ditë më pare nga forcat serbe. Në këtë varrim morën pjesë më shumë se 20 mijë veta. Në deklaraten e UÇK-së, mbajtur nga



Rexhep Selimi, mes të tjerash thuhet: “...” tani duhet të themi mjaft se ndryshe do të na mallkojë historia” Gazetarët u befasuan ndërsa turmanisi të brohorasë UÇK, UÇK! Ndërsa trupi i mësuesit zbriste poshtë, në varr, tre ushtarët e UÇK-së lëshuan breshëritë e nderimit. Ishte dëshmorë i pare që po nderohej me të shtëna armësh.

Me 5 mars 1998, në trojet shqiptare, në Drenicën kryengritëse të Kosovës, ndodhi një ngjarje e madhe, që njihet me emrin Lufta e Prekazit. Ajo luftë u zhvillua nga familja e Jasharjave, e udhëhequr prej Adem Jasharit. Ajo luftë 36 orëshe kishte në rrethim të plotë 60 burra, gra e fëmijë të ngjuar në tri godina, është një rast unik jo vetëm në historinë shqiptare por edhe në historinë botërore, ku një familje edhe pse shumë e madhe, por në një unitet mendimi dhe veprimi të jashtëzakonshëm, luftoi si një trup i vetëm dhe e gjitha, 56 pjesëtarë të saj - luftëtarë të të gjitha moshave ranë theror për çlirimin dhe kijimin e një shteti të ri – për Republikën e Kosovës.

Lufta e Prekazit nuk mori fund me sakrificën e madhe të Jasharjave me në krye Adem Jasharin, heroizëm që ju bë i njohur gjithë botës. Ajo qëndresë e ajo sakrificë, duke marrë përmasat e një legjende, nuk ishte gjë tjetër, veçse fillimi i një pikënisjeje të madhe, i një misioni me rëndësi kombëtare. Prandaj, me të drejtë, Përfaqësuesi i parë Special i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Guvernatori i parë i saj ndërkombëtar, Bernard Kushner, deklaroi: “Nëse do të kishte çmim Nobel për një lloj të tillë sakrifice, kjo familje do të ishte e para që do ta gëzonte atë”.

“Nëse nuk egziston asgjë, për të cilën ia vlen të luftosh dhe të vdesësh, atëherë nuk egziston asgjë, për të cilën ia vlen të jetosh”.

Ajo luftë heroike mori me të drejtë përmasat e një legjende. Masakra në fshatin Reçak të Kosovës, ishte pike kthese për politikën ndërkombëtare për Kosovën.

Ambasadori Willjam G. Walker udhëhoqi misionin verifikues të OSBE-së në Kosovë. Walker ishte i bindur se këto vrasje, që në fund u numëruan më shumë se dyzet, ishin rezultat i një masakre të policiesë speciale Serbe, e jo ndonjë betejë ushtarake.

Veprimet e Walkerit të shkruarjes në Reçak më 16 janar 1999 dhe doku-

mentimit të asaj që vëzhgoj, ashtu si dhe vendimi për të i shpallur publikisht vdekjet atje si masakër ndaj shqiptarëve nga forcat serbe të sigurisë ishin akte guximi profesional të një diplomati profesionist dhe të regjuri.

Vveprimet e Walkerit e shtynë përpara të bashkësia ndërkombëtare çështjen e krimeve në Kosovë që e shkurtuan kohëzgjatjen dhe i kufizuan dëmet e konfliktit.

Diplomacia amerikane u përqëndrua mbi Grupin e Kontaktit dhe vlerën e një qëndrimi ndërkombëtarë, ku do të përfshihej edhe Rusia. Për këtë u organizue Konferenca ndërkombëtare e paqes me qeverinë Franceze në Rambuje një kështjellë historike afër Parisit.

Megjithëse, Rusia e cila e kishte lejuar autorizimin e OKB-së për përdorimin e forcës në Bosnjë, ishte e paepur në kundërshtimin në rastin e Kosovës.

Me OKB-në e bllokuar nga Moska, SHBA e çoj këtë çështje tek aleatët evropianë në Nato për një mandat rajonal. Sekretarja

Madeleinë Albright i bindi qeveritë evropiane se autorizimi i OKB-së ishte i dëshirueshëm, por se nuk duhej lejuar Rusinë të i prdorte Kombet e Bashkuara për ti vënë veto një aksioni legjitim të NATO-s.

Si rezultat i kësaj këshilli veriatlantik autorizoi operacionet e Nato-s në Kosovë pa miratim specifik të OKB-së.

Ministri i jashtëm Britanik Robin Kuk i kishte thënë mediave në Rambuje: “Kam konsultuar dosjen e vitit 1913. Ne kemi qënë të padrejtë me këtë popull!”

Përfaqësuesit e Kosovës (mbi 16 veta përfaqësues të lartë të fushave të ndryshme me 7 shkurt 1999 në Rambuje kishin kryesinë e tij: Hashim Thaçi - Kryetar i delegacionit Ibrahim Rugova - zëvendëskryetar Rexhep Qosja - zëvendëskryetar Veton Surroj - zëdhënës. Ky delegacion dhe kryetari i tij paten fatin të nënshkruajnë marrëveshjen e Rambujes.

Kjo ishte marrëveshja më e rëndësishme e 100 viteve për shqiptarët e Kosovës. Shqiptarët e Kosovës për here të pare në histori po nënshkruanin ndërkombëtarisht për fatin e tyre. Kjo marrëveshje po bëhej me garancinë dhe mbrojtjen e Fuqive të mëdha

të globit. Disa po prej atyre fuqive, që e kishin refuzuar vullnetin e tyre në Konferencën e Londrës, në vitin 1913.

Gjatë fushatës ajrore Kosova ishte Serbenica e dytë, ishte masakra e Reçakut në përmasa të mëdha. Një vlersim e vë në 10 mijë numrin e shqiptarëve të vrarë nga forcat serbe gjatë 79 ditëve të bombardimeve. Nëntëdhjetë përqind e shqiptarëve në Kosovë u shëndrruan në të zhvendosur apo refugjatë drejtë Shqipërisë, Maqedonisë e Malit Zi. Vlersimet e çonin rreth 800 mijë numrin e refugjatëve dhe 700 mijë të të zhvendosurve brenda Kosovës.

Të dhëna dhe tregues që pasqyrojnë krimet e serbëve në Kosovë:

- Vrarë 11.840 shqiptar,
- 1.392 fëmijë deri në 18 vjeç;
- 296 fëmijë deri në 5 vjeç;
- 1.739 femra;
- 1.882 të moshuar mbi moshën 65-vjeçare
- 5081 të moshave 19-64 vjeçë, prej të cilëve 1.450 ende janë të pagjetur;
- Dogjën dhe shkatërruan 100 mijë e 589 shtëpi, banesa e objekte të ngjashme;
- 358 shkolla;
- 71 zyra institucionesh;
- 30 shtëpi kulture;
- 93 biblioteka publike dhe objekte shkollore;
- 123 objekte shënjendësore;
- 215 objekte fetare (çxhami, teqe, tyrbe);
- 5 kisha katolike;
- 88.101 objekte ekonomike shtetërore e private ndihmëse;
- Asgjësuan dhe grabiten 70 % të gjësë së gjallë.
- Terhoqën të gjitha evidencat e detyrimeve pensionare etj.

Gjatë fushatës ajrore pati edhe gabime...

“Një shënjestër e gabuar nga pilotët Francezë” mbi koshare. (shënimi im) “Natën e 13 majit, disa aeroplanë tanë goditën një stacion të raportuar të policiesë, jashtë fshatit Kosovar të korishës. Ne kishim vërejtur aty më herët teknikë të serbëve dhe kishim raporte se ky kompleks i ndërtesave ishte ipushtuar nga policia. Kjo e bënte kompleksin shënjestër legjitime.

Fluturakët pa pilot u përpoqën të evidentonin aktivitetet në këtë vend por, kombinimi i motit të lig dhe i aktiviteteve të armikut pamundësoj përpjekjet tona.

Pilotët vërejtën barrikada me gurë, sipas të gjitha gjasave pjesë të artillerisë, dhe automjete të policiesë, përfshirë këtu edhe një transportuar i blinduar për transport.

Por, atë që nuk e denim ishte se, mesa duket, më shumë se 100 shqiptarë ishin mbyllur aty gjatë natës dhe ishin kërcënuar se do të vriteshin nëse do të bënin përpjekje për t’u larguar. Sipas raporteve bombat tona kishin vrarë 80 shqiptarë të Kosovës-pikërisht ata njerëz, të cilët po bënin përpjekje t’i

ndihmonim”.

Wesli K. CLARK “Të bësh luftë moderne” fq.341-342.

Natyrisht që fushata ajrore nuk ishte një luftë e lehtë dhe ishte e para e llojit të saj. Ishte një ushtri mikse që merrte vendime me konsensus dhe plus ishte një luftë thjeshtë ajrore. Nga 24 marsi deri me 2 qershor 1999, mbi Serbi dhe Kosovë u hodhën 30 mijë raketa dhe bomba.

MARRËVESHJA E KUMANOVËS

Marrëveshja e Kumanovës (ose Marrëveshja ushtarako-teknike në Kumanovë) i dha fund dhunës serbe në Kosovë si një parakusht për ndaljen e bombardimeve të NATO-s mbi caqet strategjike serbe.

Me këtë marrëveshje, Serbia detyrohej të tërheqë të gjitha forcat e saj policore dhe ushtarake nga Kosova. Marrëveshjen e Kumanovës, ndërmjet NATOS dhe ish-RFJ-së, e nënshkrua më 9 qershor 1999, hyri në fuqi më 11 qershor 1999. Atë e nënshkruan Gjenerali Anglez Sir Michael David Jackson, komandanti i parë i KFOR-it në Kosovë, dhe ish-shefi i Shtabit të Armatës së Serbisë, gjenerali Nebojsa Pavkoviç, i akuzuari i Hagës për krime lufte dhe gjenocid.

Ndër të tjera në Marrëveshje parashihej:

c) që nga Kosova të largohen të gjithë personat dhe organizatat me aftësi militare duke përfshirë armatën e rregullt dhe forcat e marines, civilë të armatosur, paramilitarë, forcat ajrore, garda kombëtare, policia kufitare, rezervistët, policia ushtarake, shërbimet informative, MUP-it, policia lokale, speciale, antirebeliste, antiterroriste dhe çdo grup i përcaktuar kështu nga KFOR-i.

d) u caktua një zonë sigurie ajrore 25 kilometra përtej kufirit të Kosovës, e ndërsa në pikën e) u caktua një zonë 5 kilometrash përtej kufirit me RFJ-në që nuk guxonte të vendosen armatimet e rënda dhe ushtria, përveç ushtarët kufitarë.

Marrëveshja është arritur pas fushatës së bombardimeve të NATO-s mbi caqet serbe, e cila ka zgjatur për 78 ditë me radhë, si dhe pas përpjekjeve diplomatike për t’i dhënë fund luftës në Kosovë, gjatë të cilës mbi 15 mijë njerëz janë vrarë ose zhdukur dhe mbi një milion janë zhvendosur

Më 12 qershor të vitit 1999, në Kosovë kanë zbarkuar trupat e para të këmbësorisë së NATO-s, ndërsa ka nisur largimi i forcave serbe.

Sekretari i përgjithshëm i NATO-së Havijer Solana, më 10 qershor 1999 kishte lëshuar urdhrin për ndalimin e bombardimit dhe Këshilli i Sigurisë së OKB-së miratoi Rezolutën 1244, sipas të cilës në Kosovë u dërguan 37.200 ushtarë të KFOR-it nga 36 shtete.

Misioni ishte i ndarë në pesë zona të përgjegjësive, që i përkisnin KFOR-it amerikan, anglez, francez, gjerman dhe italian.

Me hyrjen e NATO-s, në Kosovë nisi edhe vendosja e misionit të përkohshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili do të administronte vendin për një periudhë të caktuar kohore.

Në të njëjtën kohë, është shpërbërë edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës, për t'u shndërruar në Trupat Mbrojtëse të Kosovës.

Kosova shpalli pavarësinë më 17 shkurt të vitit 2008.

Sot drejtuesit kryesor të UÇK-së ndodhen padrejtësisht në Hagë ,ata luftuan me devotshmëri , nder e dinitet për çlirimin e Kosovës dhe së bashku me NATO-n arritën ta çlirojnë atë ,dhe ta njohin mbi 100 shtete krijimin e shtetit të KOSOVËS.

UÇK-ja do të mbetet emblenë,simbol,në shpirtin ,mendjet e zemrat e çdo shqiptari dhe në shekujt që do të vine.

VENDIMI I GJYKATËS NDËRKOMBËTARE TË DREJTËSISË ME QENDËR NË HAGË

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë me qendër në Hagë, që përfaqëson gjykatën e nivelit më të lartë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, publikoi pasditen e datës 22 korrik 2010 opinionin këshilldhënës lidhur me ligjshmërinë e shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008., Kryetari i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, z. Hisashi Owada tha :

Shpallja e Pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt të vitit 2008 nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare.

Deklarata e Pavarësisë së Kosovës nuk e ka shkelur të drejtën ndërkombëtare. Sipas gjykatës nga të gjitha të dhënat del se Pavarësia e Kosovës nuk ka shkelur as rezolutën 1244, si dhe as Kornizën Kushtetuese të UNMIK-ut.

Kosova tashmë duhet të vazhdojë përpjekjet e saj me aleatët e vet strategjik për anëtarësimin në Bashkimin Evropian dhe në NATO .

Qarku i Kukësit për luftën e Kosovës

Në luftën e fundit të Kosovës ,në një fare mënyre u përfshi i gjithë kombi shqiptar, sidomos ai i Qarkut të Kukësit .

Në fshatin Papaj të rrethit të Tropojës u ngrit u përgatit u konsolidue Brigada e 128 e UÇK-së “AGIM RAMADANI”, e cila në prill 1999 mori Kosharen . Komandanti i saj Rrustem Berisha arriti të i harmonizoj të , bashkoj e konsolidoj oficerët e FARK-ut dhe pjesës tjetër të UÇK-së që ishin betue për çlirimin e Kosovës pa asnjë kompromis që për shumë kohë secila pale kishin “vretjtjet” e veta çështje “besimi” e “përgatitje” ,por ja dolën me sukses.

LISTA EMERORE E SHTETASVE SHQIPTARË RËNË PËR PAVARSINË E KOSOVËS SHPALLUR "DËSHMORË TË ATDHEUT" NGA R.SHQIPERISË

NR	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	GJINIA	DATLINDJA	VENDLINDJA	VENDBANI MI	NR. VENDIMIT	D. VENDIMIT	VITI RËNIE S
1	ADEM	BAJRAM	SELMANI	M	02.07.1967	Tropojë	TROPOJË	101	21.12.2007	1998
2	ARIF	SHPEND	DAUTAJ	M	01.10.1959	Gegaj	TROPOJË	23	27.02.2004	1998
3	BILBIL	HAZIR	BREÇANI	M	13.05.1974	Markaj	TROPOJË	23	27.02.2004	1999
4	FATMI R	REXHEP	HASANDOÇAJ	M	14.02.1978	B.Curri	TROPOJË	23	27.02.2004	1998
5	HAZIR	AVDYL	MALAJ	M	28.09.1941	T!pla	TROPOJË	48	17.03.2005	1998
6	HYRË N	MEHMET	DEMIRAJ	F	12.06.1919	Markaj	TROPOJË	48	17.03.2005	1999
7	HYSE N	ISMAIL	MELLA	M	01.12.1964	Buçaj	TROPOJË	69	28.09.2007	1999
8	HYSNI LULZI M	ADEM	HAJDARMATAJ	M	15.07.1946	Zherkë	TROPOJË	60	23.12.2005	1999
9	MAN MEHM ET	ARIF	SALLAHU	M	14.05.1934	Gegaj	TROPOJË	52	10.05.2005	1999
10	MEHM ET	RAM	DEZDARI	M	04.08.1970	Tropojë	TROPOJË	27	14.05.2004	1998
11	QAZIM	HAZIR	DAUTAJ	M	01.09.1952	Gegaj	TROPOJË	23	27.02.2004	1998
12	RAM	REXHEP	SALLAHI	M	18.03.1935	Gegaj	TROPOJË	48	17.03.2005	1999
13	RAMIZ	RAM	MEMIA	M	15.09.1933	Tropojë	TROPOJË	27	14.05.2004	1998
14	SHPE ND	REXHE	HAJDARMATAJ	M	05.06.1967	Zherkë	TROPOJË	575	7.03.2012	1999
15	TAHIR	SHABAN	HOXHA	M	15.09.1933	Tropojë	TROPOJË	48	17.03.2005	1999
16	TAHIR	RAM	MEMIA	M	15.08.1968	Myhejan	TROPOJË	27	14.05.2004	1998
17	TAHIR	MALE	SINANI	M	25.07.1962	Gri	TROPOJË	32	07.07.2004	2001
18	XHEMI LE	MAKEL	SALLAHU	F	19.10.1920	Dragobi	TROPOJË	48	17.03.2005	1999

1	ADEM	UKË	MAZREKU	M	11.01.1963	Vranisht	HAS	7	12.03.2003	1999
2	AGIM	ISMAIL	MUJA	M	04.03.1970	Krume	HAS	7	12.03.2003	1998
3	ARTAN	XHEM	KOVAÇI	M	01.04.1982	Vlahen, Has	HAS	7	12.03.2003	1999
4	ASTRI T	SELMAN	RRUSHI	M	02.04.1970	Qarr	HAS	7	12.03.2003	1999
5	BESMI R	AZEM	BRATI	M	12.02.1970	Golaj	HAS	7	12.03.2003	1999
6	DIN	ALUSH	KOLECI	M	10.11.1938	Kishaj	HAS	7	12.03.2003	1998
7	HALIM	ZENUN	BARDHOSHI	M	18.05.1947	Peraj	HAS	7	12.03.2003	1998
8	HAMDI	MUHARR EM	MULAJ	M	31.05.1964	Dobrunë	HAS	7	12.03.2003	1999
9	ISA	DERVISH	THACI	M	01.05.1966	Domaj	HAS	574	7.03.2012	1998
10	ISA	PESHK	MALAJ	M	09.12.1942	Peraj	HAS	7	12.03.2003	1998
11	MERIMAN	UKË	DAUTI	M	07.08.1977	Zahrisht	HAS	7	12.03.2003	1999

12	MERIT A	MUS	CAHANI	F	20.02.1977	Cahan	HAS	646	08.04.2013	1999
13	NAIM	HAJDAR	QEMO	M	11.06.1977	Kishaj	HAS	7	12.03.2003	1998
14	XHAVI T	IBISH	LLESHI	M	19.03.1955	Kishaj	HAS	27	14.05.2004	1998
15	XHELA DIN	QAZIM	DAUTI	M	23.04.1955	Galaj	HAS	7	12.03.2003	1998
16	LULËZ IM	SADIK	MORINA	M	02.04.1973	Pogaj	HAS	869	21.06.2021	1994
17	SKËN DER	RASIM	MORINA	M	24.05.1970	Pogaj	HAS	870	21.06.2021	1994
18	XHEV AT	AJET	LLESHI	M	21.06.1969	Kishaj	HAS	871	21.06.2022	1998

1	HALIT	RIZA	COKA	M	25.08.1974	Arren	KUKËS	7	12.03.2003	1999
---	-------	------	------	---	------------	-------	-------	---	------------	------

1	ASTRI T	HEKURAN	SULI	M	13.04.1976	Luzaj	KUÇOVË	2	28.01.2000	1998
2	INDRI T	LULZIM	CARA	M	11.07.1971	Kavajë	KAVAJË	7	12.05.1999	1999
3	LEFTER	LUTFI	KOXHAJ	M	1.10.1969	Nishovë	SKRAPAR	397	25.04.2011	2001
4	NDRIÇ IM	SHERIF	KOXHA	M	24.05.1971	Gizovesht	LIBRAZHDI	60	23.12.2005	2001
5	RAM	MUS	GECA	M	17.03.1980	Libizhdë	KOSOVË	7	12.03.2003	1999
6	SKER DILAI	BARDHY L	LLAGAMI	M	31.10.1969	Tiranë	TIRANË	32	07.07.2004	2001

Këshilli Bashkiak i Tropojës vendosi të emërtoj rrugën Buçaj –Papaj-Padesh “RRUGA E LIRISË”, në këtë rrugë marshuan ditën e natën me dhjetra e qindra ushtarë e oficerë të UÇK-së , në këtë rrugë u transportuan armatime,teknikë e municione ...dhe kjo rrugë do të mbajë këtë emer të mire duke nderuar Shipshanin.

Sepse Shipshani, Tropoja ,Hasi ,Kukësi dhanë një ndihmesë të fuqishme me përgatitjen e personelit të UÇK ,për të luftuar në fushën e betejës. Ndihej në furnizimin e këtyre trupave me armatim e municion, kontribuoi duke marrë pjesë direkt në luftime me dhjetra ushtarë dhe oficer që nga Tahir Sinani,Bilbil Breçani ,

Fatmir Hasandoçi dëshmorë të atdheut dhe oficer të tjerë që ishin e kontribuan në front (Rakip Sadiku ,Besim Kuçana, Petrit Rrahmani, Ali Kuliçi , Feriz Trezhnjeva Vexhi Halili etj...)

Nuk mund të lë pa përmendur komandantin e pikës së zbulimit Padesh Ramiz Tafën ,që së bashku me vartësit e kolegët e tij ,ku sipas shënimeve të datës 28 e 29 maj 1998, kanë qenë: Shaqir Kuçana, që fatkeqësisht në mars 2000 ka ra në minat serbe dhe shpëtoi, Halil Zeneli edhe ky ra në mina duke humbë njërën këmbë dhe më vonë ndrooi jetë, Hasim Kuca, Sadik Sallahi, Mehmet Memia, Sherif Mella edhe ky ra në mina më vonë

dhe shpëtoi, e Agron Mala.

Duhet theksuar se kjo pike zbulimi nuk lëvizti asnjëherë nga ky vend , ishte ishte syri e veshi i Kom . Brigadës e Divizionit ,edhe pse në kushte të vështira ,asnjëherë nuk u spraps të lëshonte këtë pike, edhe pse shpesh herë kishte sugjerime edhe nga eprorët

Populli i këtij qarku priten , strehuan ,ushqeyen me qindra e mijra shqiptar të Kosovës (pleq,gra e fëmij) të shpërngulur me force nga trojet e tyre nga forcat serbe , nga më shumë se 30 mijë priten Tropoja e Hasi që me 31 maj 1998 dhe pastaj Kukësi me 1999 mbi 500 mijë i cili u propozue dhe ishte kandidat për çmimin NOBEL.

Gjatë periudhës së luftës në zonat kufitare, ku kishte aktivitet u minue nga forcat serbe deri 1 km e më shumë në thellësi të kufirit shtetëror , për pasojë ky Qark pati pasoja jo të lehta .

Konkretisht : Tropoja 141 veta ranë në mina ,nga këta 14 të vrarë , me plagosje të rënda 37 veta ,(humbje gjymtyre, humbje shikimi , dëmtime të rënda të tjera trupore) si dhe 90 veta me plagosje të lehta.

Hasi 87 veta ranë në mina ,nga këta 8 të vrarë, 22 me plagosje të rënda, dhe 57 me plagë të lehta .

Kukësi 40 veta kanë rënë në mina ,nga këta 6 të vrarë , 15 me plagë të rënda , 19 me plagë të lehta.

Si Qark : 28 të vrarë ; 74 me plagë të rënda dhe 166 me plagë të lehta . Gjithsejt 268 veta të aksidentuar në mina.

(Këto lista(janë të shqiptarëve të Shqipërisë) dhe ndodhen në zyrat e përkrahjes së Qeverisë Kosovës dhe në organizatën e veteranëve të UÇK-së)

(Të ndarë sipas rretheve janë :19 -TROPOJA; 18 -Hasi; 1-Kukësi; 1-Kuçova;1-Kavaja;1-Skra- pari;1-Librashdi;1- Kosova; dhe 1-Tirana , gjithsejt 44 dëshmorë të atdheut .)

Në këtë përvjetor që shënon një çerek shekulli nga ndërhyrja e Nato-s, mund të jetë edhe moment për reflektim për shumçka që u bë e mund të bëhej apo që duhet bërë më mirë.

Por një gjë mbetet e përgjeshme; Lavdia e dëshmorve të atdheut që ranë për çlirimin e Ksovës. Padyshim që mirënjohja mbetet pakufishme për të gjithë ata që kontribuan për çlirimin e Kosovës. Miqtë e mëdhenj të kombit shqiptar kanë përmendore në zemrat e çdo shqiptari.

Por kurrë nuk mund të harrohet kontributi i jashtëzakonshëm i të gjithë atyre oficerëve, nënoficerëve, aktiv e rezervist të qarkut të Kukësit në fushat e përgatitjes luftarake dhe në frontin e luftës..

Mirënjohje te përgjeshme për organet e pushtetit vendor të Qarkut Kukësit për punën e tyre të jashtëzakonshme në pritjen e vllëzërve të tyre të Kosovës.

(Punën dhe aktivitetin e tri bashkive Institucionit Prefektit dhe Këshillit të Qarkut mu dha mundësia që së bashku me administratën e Prefektit të Qarkut të digjitalizohej mbi 2200 faqe aktivitet të pushtetit vendor dhe ajo ndodhet sot pranë administratës së Prefektit të Qarkut Kukës.)

Në këtë përvjetor që shënon një çerek shekulli nga ndërhyrja e Natos, shpresa vazhdon, si ëndërr e ardhur prej brezash e brazash të tërë, si amanet stërgjyshor; bashkimin i kombit shqiptar në trojet e veta autoktone

Ish Komandant i Brigadës Tropojës Ish Prefekt i Qarkut Kukësit

BLERJA E PUSHTETIT ME LLOKMA SHQIPËRIE

ANDI BUSHATI

Dy mediave serioze në vendet e tyre, L'Espresso në Itali dhe New York Times, duke hetuar dyshimet për veprime okulte përgjatë fushatave elektorale, u ka dalë përpara Edi Rama. E përjavshmja e së majtës italiane, i ka kushtuar investigimin që zë dhe ballinën e revistës me titullin "Giorgia, mbretresha e Shqipërisë", marëveshjes për hapjen e kampeve të refugjatëve në Shëngjin dhe Gjadër.

I gjithë sfondi i shkrimit, me shpenzime dhe shifra të detajuara, tregon se si qëllimi këtij pakti me kosto mbi 100 milionë euro është që në territorret shqiptare, të cilat Rama i ka kaluar nën sovranitetin italian, të ngrihet flamuri tre ngjyrësh i fqinjëve tanë përpara zgjedhjeve evropiane të fillim të qershorit.

Por kjo qokë për Melonin, nga njeriu që kishte deklaruar publikisht se vendi ynë nuk do të bëhej kurrë strehë për kampe emigrantësh nga shtetet e pasuara, nuk është asgjë përballë asaj që na nxjerr në dritë gazeta prestigjioze amerikane. Duke investiguar për një temë të preferuar të saj, që është përdorimi i pushtetit të familjes Trump për biznese personale,

New York Times na tregon se kryeministri ynë po kërkon të lajë me favore të pa imagjinueshme shprehjen "Turpi i njerëzimit", që pati thënë dikur për Donald Trumpin.

Edi Rama po bën çështje e mundur përmes ish ambasadorit Richard Grenell, lidhjeve të përbashkëta me Vuçiqin, fuqisë financiare të Shefqet Kastratit, për ti dhënë vazhës së Trump dhe dhëndrit të tij Jared Kushner, ishullin e Sazanit dhe Zvërnecin e Vlorës.

Artikulli shpjegon se si dhëndëri i ish presidentit, këshilltari kryesor gjatë ushtrimit të detyrës nga Trump, kanë ardhur dy herë në Shqipëri dhe janë takuar me Ramën. Se bashkë me ambasadorin Grenell, njeriun më proserb në raportet me Kosovën, i cili rrezoi qeverinë Kurti kur shërbeu si i dërguar special i ShBA në Ballkan, ata do ndërtojnë edhe në një ish bazë ushtarake pranë Beogradit.

NYT kujdeset të theksojë se këto janë prona publike, çka tregon se për investimet e familjes Trump do negociohet me qeveritë, me të cilat Kushner dhe Grenell i kanë pasur lidhjet si pasojë e funksioneve që kanë mbajtur në të shkuarën.

Për gjatë investigimit të kryer nga tre gazetarë, dy prej të cilëve qëmtojnë konfliktet e interesit gjatë fushatës



presidenciale amerikane, citohet edhe Robert Weissman, nga Public Citizen, që i cilëson këto marëveshje si shembuj që ngërthejnë tendencat më të këqia korruptive të familjes Trump.

Po i shkruar kështu, sipas këndvështrimit të gazetës njujorkeze, ky është thjeshtë halli i amerikanëve. Ai i qytetarëve të tyre që shohin se si ata që i udhëheqin, përdorin lidhjet politike me dordolecë që drejtojnë republika bananesh, për tu pasuruar për veten e tyre.

Ndërsa pyetjet që lindin për ne në Shqipëri janë të tjera. Pse kur L'E-

spresso gjurmon mashtrimet elektorale italiane, përpara i shfaqet Rama? Pse kur New York Times heton konfliktin e interesit të dhëndrit dhe vazhës së Trump, del po i njëjti? Pse kur kongresmenët amerikanë kontrollojnë liderët që kanë shpenzuar para në hotelin e presidentit Trump, në Uashington, përsëri figuron emri i kryeministrit të vendit më të varfër në Evropë? Pse kur FBI shqetësohet korruptimin e agjentit të saj, sërish rezultati është njësoj?

Natyrisht, si qytetarë globalë, ne mund të na interesojë dyfytyrësia e një post fashisteje si Giorgia Meloni,

prirjet për ta shndëruar politikën në allishverish biznesi nga ai që mund të bëhet sërish, sipas të gjitha gjasave, i pari i Amerikës, apo fraxhiliteti i FBI së për tu korruptuar nga dy delinkuentë. Por, brenda botës sonë të vogël, e kemi me detyrim të shtrajmë çështjen: si është e mundur që kryeministri liliput i një vendi me buxhet vetëm 7 miliardë euro, arrin të blejë kë të dojë? Si ka mundësi që ai reket të ndikojë politikën e brendshme italiane dhe të kapërcejë, pa i hyrë gjemb në këmbë, nga klintonët si ikona civilizimi, tek trumpët si turpi i tij?

Përgjigjen për këtë nuk duhet ta kërkojmë as të shprehja që e përdorin shpesh me ironi mbështetësit e Ramës se, "ky qenkërka i aftë të korruptojë gjithë botën", as tek bjerrja morale e vlerave të perëndimit.

Përgjigjen, së pari duhet ta gjejmë brenda nesh, tek lejimi i një sistemi autokratik, tek pranimi i idesë së një vendi me një pronar të vetëm, i cili, për të blerë mbështetje politike jashtë, fal llokma Shqipërie dhe përdor fondet e koncesioneve dhe "investimeve strategjike". Faji nuk është vetëm i ndërkombëtarëve që blihen, por mbi të gjitha i yni, që kemi pranuar të shesim demokracinë.

KUSH NA MBRON NGA DHËNDRI I TRUMP?

OLA XAMA

Shumë kanë mbetur të çuditur nga artikulli i New York Times se dhëndri i ish-presidentit amerikan Donald Trump, Jerad Kushner, ka në plan për të ndërtuar resort turistik në ishullin e Sazanit dhe në gjirin e Portonovit. Disa ndihen të gëzuar, të tjerë të shqetësuar për mënyrën se si po ndahen pasuritë e vendit dhe një pjesë kanë ngelur në mesin e 'bllofit' politik.

Ata që ndihen të lumtur janë rrethi i njerzve pranë kryeministrit, të cilët do të zgjatin disa vite më shumë pushtetin. Një rreth pak më i madh gëzohet se me Sazanin do të kenë të sigurtë rrogën dhe ca kohë, ndërsa ata që nuk kuptojnë, lumturohen pasi mendojnë se ekonomia jonë do të zhvillohet aq shumë sa qeveria do t'u rritë pensionin.

Për të kuptuar fitimin nga projektet e investimeve strategjike në bregdet, duke marrë si paradigme faktin se turizmi do të jetë promotori i ekonomisë

së vendit, pyetja e parë që shtrihet është se sa ka ndërmend kryeministri të bëjë peshën e turizmit në ekonomi? 10% sa është sot apo 20 dhe 30% të GDP? Drejt cilës strukturë ekonomike do të shkojmë, të vendeve të G7 apo atyre të Afrikës dhe Karaibeve?

Nëse e bëjmë nul paragrafin e mësipërm dhe pranojmë se turizmi do të jetë sektori kryesor i ekonomisë tonë, pyetja tjetër që shtrihet është sa do të jetë përfitimi ekonomik që do të kemi nëse vendosim të bëjmë resorte në këto dy zona?!

Një udhëheqës që mendon për vendin e tij do të vepronte kështu: do të niste hartimin e një studimi i cili do të zbulonte potencialet e ndikimit në ekonomi nga zhvillimi i Sazanit dhe Zvërnecit. Kjo punë shkencore do të nxirrte raportet se sa para do të përfitonte ekonomia e ndarë sipas buxhetit të shtetit dhe në formë direkte të qytetarët. Nëse do të kishte leverdi, atëherë do të hapte garën për të parë mos ka ndonjë investitor që jep diçka më shumë se skenari bazë i studimit për pjesën që i ndahet shtetit ose pub-



likes.

Kjo procedurë jo vetëm që nuk ka ndodhur, por shohim se është ndjekur një rrugë tërësisht sekrete për të ndryshuar Ligjin për Zonat e Mbrojtura, shtyrë me 1 vit Ligjin për Investimet Strategjike e mbase dhe nxjerrjen e Sazanit nga Plani i Përhapjes së ushtrisë për të miratuar kërkesën e Kushner. Dhjetra institucione që duhet të kërkonin llogari për procedurën me në krye Kuvendin dhe Presidentin thjesht po shihen teksa 'noterizojnë' kërkesat e udhëheqësit. Në gjithë këtë mes kemi dhe një grup

tjetër që duket se kanë çeduar në sistemin tonë të quajtur demokratik. Të dy opozitat dhe parti të ndryshme politike (të reja e të vjetra), nuk reagojnë dhe as kundërshtojnë këtë që po ndodh.

Në çdo rast tjetër nëse demokracia do të funksiononte, garancinë për 'rëshkitjen' e saj do e jepte forca kundërshtarë. Në këtë rast disa ndihen të kompleksuar, të tjerë duket se pranojnë që po të ishin në këtë pozitë do të vepronin njëllëj.

Të vetmit të zhgënjyer nga kjo që po ndodh janë ata që mendojnë se Amerika ditë e natë punon dhe shqetësohet për ne. Si ka mundësi ta marrë Sazanin në këtë formë një ish-zyrtar i lartë amerikan?! Këta janë ata delirantët që ecin me duar në xhepa dhe mendojnë se një ditë të bukur shqiptarët do të kenë lirinë, demokracinë dhe mirëqënien vetëm sepse do t'ia 'sjellin me aeroplan aleatët e huaj'.

Shqipërinë nuk e mbrojnë Edi Rama dhe as opozita. Nuk e mbrojnë sigurisht as partnerët ndërkombëtarë, të cilët veprojnë brenda kornizës së tyre dhe interesave të vendit për të cilën ata punojnë. Shqipërinë e mbrojnë dhe mund ta mbrojnë vetëm shqiptarët.

Është populli që ka në dorë dy instrumenta demokratikë: votën dhe protestën. Nëse e doni vendin, nëse nuk doni të jepet si plaçkë për pushtetin e çdokujt, nëse doni që me pasurinë tuaj të mos shtoni pasurinë e më të pasurve (shqiptarë apo të huaj qofshin), dilni dhe ndaleni

TËHUAZIMI I SHQIPTARËVE NË MAQEDONINË E VERIUT

DAUT DAUTI

Kriza e Maqedonisë doli në sipërfaqe me Kryengritjen e Ilindenit, e cila u zhvillua në gusht të vitit 1903.

Nga kjo rezultoi Republika e Krushevës, që nxori një kuvend dhe një qeveri të përkohshme.

Që të dy këto institucione kishin numër të barabartë të anëtarëve.

Kuvendi kishte 20 anëtarë shqiptarë, 20 maqedonë dhe 20 vllahë.

Nga dy anëtarë të këtyre bashkësive kishte edhe qeveria.

Pas Kongresit të Berlinit (1878), mbledhjes më të madhe diplomatike që kishte parë Europa deri atëherë dhe e cila nuk e mori parasysh çështjen shqiptare, rilindësit shqiptarë e shtuan aktivitetin e tyre patriotik në Maqedoni. Udhëheqësit shqiptarë u aktivizuan për dy arsye. Arsyeja e parë ishte fakti që ky kongres paralajmëroi përfshirjen e vendeve fqinje (Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë) në çështjen e Maqedonisë, kurse fakti i dytë ishte numri dominues i banorëve shqiptarë në pjesën qendrore, sidomos në atë perëndimore të këtij rajoni. Prandaj, udhëheqësit shqiptarë planifikonin që kufijtë e shtetit të ardhshëm shqiptar duhej të vendoseshin diku në Maqedoni. Kjo ishte edhe arsyeja që ata organizuan kryengritje, por edhe ngjarje të rëndësishme kulturore e politike në Maqedoni. Madje, planifikohej që Shkupi të bëhej kryeqyteti i shtetit të ardhshëm shqiptar.

Kriza e Maqedonisë doli në sipërfaqe me Kryengritjen e Ilindenit, e cila u zhvillua në gusht të vitit 1903. Nga kjo rezultoi Republika e Krushevës që nxori një kuvend dhe një qeveri të përkohshme. Që të dy këto institucione kishin numër të barabartë të anëtarëve. Kuvendi kishte 20 anëtarë shqiptarë, 20 maqedonë dhe 20 vllahë. Nga dy anëtarë të këtyre bashkësive kishte edhe qeveria. Pra, ajo që tregojnë shifrat, është barazia që këta popuj kishin proklamuar si fakt dhe pranuar si nevojë të domosdoshme që dilte nga realiteti politik që e nxirrte në pah faktori gjeografik dhe demografik. Kryengritja nuk do të bëhej pa pjesëmarrjen e shqiptarëve, për shkak se ata e kontrollonin armatimin dhe logjistikën në rajon.



Më vonë, për shkak të përzjerjes së Bullgarisë, Serbisë dhe Greqisë, gjërat u zhvilluan aq keq, saqë u harua barazia e proklamuar. Këto tri shtete e minuan idenë e Republikës së Krushevës dhe kryengritja, në vend që të ishte kundër pushtetit osman, u shndërrua në vrasje e masakra të këtyre grupeve që ushtruan ndaj njëra-tjetrës. Për ta komplikuar gjendjen edhe më tej, kryengritësit e mbështetur politikisht dhe me pajisje ushtarake nga fqinjët, ushtruan masakra edhe ndaj myslimanëve. Prandaj, në Europë Maqedonia filloi të shihej si vend i një konflikti të komplikuar të të krishterëve me myslimanët. Dhe, dihej se në cilën anë ishte Europa.

Pos Edith Durhamit dhe Aubrey Herbertit, të rrallë ishin tjerët që bënë me dije se Maqedonia ishte problem i kombeve e jo problem religjioz. Madje, Durhamit dhe Herberberti, duke bërë me dije se problem kryesor i Maqedonisë ishte injorimi i çështjes shqiptare, e identifikuan dhe e shpjeguan këtë çështje në thelb. Megjithatë, numri i opinionbërësve dhe vendimmarrësve në politikë, që mendonin ndryshe, ishte më i madh.

Kur fuqitë europiane u mblodhën në qershor të vitit 1908 në Reval, çështja u komplikua edhe më shumë pasi që reformat në Maqedoni nuk tregonin rezultate. Kjo ishte për arsye se vendet fqinje ishin kundër reformave dhe dëshironin ta mbanin Maqedoninë në krizë të përhershme dhe në këtë mënyrë të vërtetonin se Perandoria Otomane ishte “E sëmurë e Bosforit”, një shprehje që e kishte lansuar në qarkullim ideologjia pansllave. Rusia merrte gjithnjë e më shumë të drejta të përzjerjes në Ballkanin përmes Maqedonisë. Kjo krijoi një shqetësim të madh të oficerët otomanë, të cilët u organizuan në një lëvizje sekrete, e cila në Europë filloi të quhej Lëvizja Xhonturke. Për

shkak se krerët shqiptarë kishin arsye që të brengoseshin më së shumti për të ardhmen e Perandorisë Otomane, nga e cila gjë varej edhe fati i çështjes shqiptare, u organizuan në këtë lëvizje.

Madje, Ibrahim Temo, një shqiptar ushtarak nga Maqedonia, ishte ndër të parët që u angazhuan në këtë lëvizje dhe për këtë arsye historia e njeh si “Xhonturku Numër Një”, për shkak se ai ishte anëtar i parë në qelizën e parë sekrete të kësaj organizate. Shqiptarët shihnin zgjidhje të çështjes së tyre kombëtare në këtë organizatë dhe iu bashkuan me numër të madh, sidomos ata ta Maqedonisë që kishin funksione ushtarake e politike në hierarkinë e perandorisë.

Dy oficerët udhëheqës kryesorë të Revolucionit Xhonturk, Enver Beu dhe Nijazi Beu, ishin shqiptarë nga Maqedonia. Pastaj, Revolucionit kulmoi në Ferizaj, por u bë për shkak të Maqedonisë që tani më ishte bërë thelbi i çështjes shqiptare.

Kur triumfoi revolucioni, në Manastir u organizua paradë ushtarake dhe udhëheqësi, Nijazi Beu, hyri në qytet me ushtri në mënyrë ceremoniale, duke qenë i shoqëruar nga Çerçiz Topulli, udhëheqësi i gueriljes shqiptare, dhe nga Apostol Mijalkovski, udhëheqës i gueriljes maqedone. Ky veprim simbolizonte bashkëpunimin shqiptar-maqedon, si edhe barazinë e tyre. Në Selanik u ndriçua qyteti kur atje u kthye Enver Beu me ushtarë e tij si fitues nga Maqedonia.

Kur pas revolucionit u organizua Kongresi i Alfabetit (1908), Manastirin shqiptarët nuk e zgjedhën rastësisht si vend. Qëllimi i tyre ishte që bullgarëve, maqedonëve dhe tjerëve t’u bëhej me dije se ky qytet është brenda territorit shqiptar. Gjatë po atij viti, në Selanik, Mid’hat Frashëri filloi ta botonte gazetën “Lirija”. Nën

titullin e gazetës si vend i botimit nuk figuronte qyteti Selanik, por shkruante “Botohet në mes të Shqipërisë”. Pra, udhëheqësit e asaj kohe bënë me dije se deri ku duhej ose, së paku, deri ku ata aspironin që të shtrihet kufiri i shtetit shqiptar.

Por, për fat të keq, çështja shqiptare vazhdoi të injorohej dhe dihet se si përfundoi shtrirja etnike e shtetit shqiptar. Pas okupimit të Maqedonisë nga Serbia dhe krijimit të Jugosllavisë, u bë më lehtë të imponohet injorimi i shqiptarëve. Shqiptarët e Maqedonisë u vranë në mënyrë masive, kurse një numër i madh i atyre që mbetën gjallë u përzonë nga shtëpitë dhe tokat e tyre. Në llogarinë e shtetit të ri jugosllav dhe në sytë e opinionit botëror çështja shqiptare pushoi së ekzistuar. Ky ka qenë qëllimi dhe, për fat të keq, kjo ide është përvetësuar edhe nga vetë shqiptarët. Edhe sot në tekstet historike dhe punimet shkencore të shqiptarëve Maqedonia nuk trajtohet si territor esencial i shqiptarëve. Nga Kosova, sidomos nga Shqipëria, shqiptarët e Maqedonisë injorohen dhe shpesh shihen me përbruzje. Ideja e injorimit të Maqedonisë si shqiptare ka krijuar efekt të tëhuazimit të shqiptarët mu ashtu siç është planifikuar.

Një qasje e këtillë, pa dyshim tërësisht e papranueshme, është bartur në mentalitetin e shumicës së politikanëve shqiptarë në Maqedoninë e sotme, e cila së voni e mori shpesh “e Veriut”. Emërtimi i ri i këtij shteti u bë për shkak të presionit të shtetit grek. Por, nuk kishte asnjë presion ndaj Maqedonisë nga shteti shqiptar ose opinionin shqiptar, edhe pse ky vend historikisht dhe sot faktikisht përbën element të rëndësishëm shqiptar në vete, saqë ekzistenca e tij varet tërësisht nga disponimi i shqiptarëve.

Dështimi i faktorit politik shqiptar nga Tirana në Prishtinë e deri në

Shkup shihet në gjendjen e pabarazisë së shqiptarëve në Maqedoni. Më së miri këtë gjendje e paraqet kushtetuta e këtij vendi, e cila nuk i njeh shqiptarët si shtetformues. Për këtë arsye, sipas kësaj kushtetute, shteti është rezultat i orvatjeve të maqedonëve për liri dhe pavarësi të Maqedonisë. Për të qenë ironia më e madhe, kushtetuta proklamoi se Maqedonia e sotme është e bazuar në parimet e Republikës së Krushevës. Duhet përsëritur edhe një herë se në Republikën e Krushevës shqiptarët dhe maqedonët ishin të përfaqësuar në mënyrë të barabartë, si edhe orvatjet dhe aktivitetet e tyre. Nga ky fakt shihet se kjo kushtetutë e ka shkelur mu parimin kryesor mbi të cilin pretendon se është ngritur republika e re. Edhe më e pakuptimtë, dhe nga kjo edhe më e papranueshme, është fakti që kjo kushtetutë nuk e pranon përdorimin e termit “gjuha shqipe”. Në vend të gjuhës shqipe figuron shifra “20%”. Pra, shqiptarët janë shndërruar në shifër (20%) edhe pse regjistrimi i fundit tregon se ata përbëjnë 30% të popullsisë. Madje, edhe në arritjen e kësaj pike ku tashti gjenden shqiptarët, kishte refuzime që dilnin nga faktori politik maqedon. Faktori maqedon është sjellë sipas “zemërgjerësisë” së zotëriut ose sunduesit, duke e aplikuar parimin “të jap të drejta aq sa e shoh unë të arsyeshme”.

Problemi këtu bëhet më i madh për shkak se politikanët shqiptarë e kanë pranuar këtë relacion me maqedonët. Këta politikanë, sidomos partia në pushtet (BDI), duket se është e kënaqur me shpërblimet që ia japin me pozita në pushtet.

Kjo gjë u pa me emërimin e Talat Xhaferit për kryeministër, që u paraqit si arrije e partisë në pushtet ose si sukses i saj në luftën e barazisë. Në realitet, pozita e një kryeministri në një qeveri teknike, e cila ka kompetenca dhe kohë të kufizuar, është e parëndësishme. Sikur Talat Xhaferi të dilte kryeministër nga zgjedhjet, gjërat do të ishin në rregull dhe për lëvdatë jo vetëm për shqiptarët, por edhe për maqedonët. Por, ja që gjërat janë ndryshe.

Pra, është harruar zhvillimi i historisë politike të Maqedonisë, e cila flet në favor të barazisë së shqiptarëve me maqedonët.

Në vend të kësaj barazie ende qëndron e pranuar ideja e injorimit të çështjes shqiptare. Pra, çështja zgjidhet sipas masës që mendojnë maqedonët se është e nevojshme për shqiptarët. Në rrethana të këtyra përfitojnë, kryesisht materialisht, vetëm ata që janë në pushtet ose afër tij. Kjo nuk e ndryshon gjendjen e pafavorshme të shqiptarëve në këtë vend. Shqiptarët në Maqedoninë e Veriut ende janë të tëhuazuar.

Dotech
websites 

**Akoma nuk
keni Website?**

PROFESSIONAL

**AKOMA NUK JENI TË
REGJISTRUAR NE GOOGLE?**

ADRESA E ZYRAVE

**30 AVENONS ROAD
LONDON E13 8HT**

Responsive Website

Custom Website Design

Redesign Website

Web Development

Mobile App Design

E-commerce Solutions

KONTAKTONI



020 7018 7929



073 4066 5946



VETON SURROI

MINISTRIA E KUJTESËS

Rreth Rambouilletsë, qebapëve, qarkut intelektual e politik francez dhe mallkimit të harresës

1.

Këtë javë u bë një çerek shekulli nga përfundimi i Konferencës së Rambouilletsë, me aktin ceremonial të nënshkrimit në Pallatin Kleber në Paris.

Kjo ishte hera e parë në historinë e Kosovës që populli i saj shumicë, shqiptarët, të nënshkruajnë një marrëveshje me botën demokratike. Delegacioni i Kosovës për herë të parë në historinë e vendit u dakordua si palë mbi rrugën e mëtejme të vendit me bashkësinë euroatlantike.

Me këtë marrëveshje nuk u pajtuan Serbia dhe Rusia, dhe kjo është një pjesë e rrëfimit që vazhdon deri më sot. Por, pjesa e kontratës me bashkësinë euroatlantike është më rëndësi, sepse është e vënë në themelin e shtetësisë së Kosovës.

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes në Paris, NATO-ja ndërmoi fushatën e vet ajrore me të cilën e çliroi Kosovën nga prania ushtarake, policore dhe administrative të Serbisë.

Kombet e Bashkuara vendosën administrimin e vet të përkohshëm në Kosovë dhe në pajtim me Marrëveshjen e Rambouilletsë, të kodifikuar në Rezolutën 1244 të KS të OKB, u zhvillua procesi Ahtisaari me të cilin u arrit shpallja e dakorduar e pavarësisë; pra e dakorduar mes Kosovës dhe një pjese të madhe të botës demokratike.

E megjithatë, një përvjetor që në sytë e historisë duhej të ishte i rëndësishëm, kaloi pothuajse pa u përmendur fare në hapësirën publike shqiptare të Kosovës.

2.

Një zhvillim i këllillë po më duket si një fenomen me të cilin po merrem jo pse kam qenë njëri prej nënshkruesve të Marrëveshjes së Rambouilletsë, dhe rrjedhimisht supozohet se duhej të isha i prekur nga mospërfillja për këtë ngjarje. E kam thënë disa herë, dhe e përsëris tani, se po të mos kisha bërë asgjë tjetër në jetë, do të mjaftonte nënshkrimi i Marrëveshjes për ta konsideruar një jetë të plotë.



Por, rasti me çerekshekullin e Marrëveshjes më intrigon si çështje që ka të bëjë me fenomenet e harresës kolektive dhe të kujtesës kolektive.

Ta marrim të mirëqenë harresën. Njeriu harron ku i ka lënë çelësat, pas disa vjetësh emrat e njerëzve të cilët i ka njohur, datat e ngjarjeve, qytetet, ndonjëherë vitet e ngjarjeve të rëndësishme - dhe jo rrallë ditëlindjet e njerëzve të afërm. Si individë jemi të dënuar që të harrojmë, kjo është pjesë e procesit natyror të humbjes së vetive fizike dhe psikike. Rrjedhimisht, kjo vlen edhe për shoqëritë; në vorbullën e përditshme të informatave, është lehtë të përqendrohesh në përditshmëri dhe të harrosh një ngjarje, sado epokale, të para çerekshekullit. Kjo vlen edhe më shumë për ata që kanë lindur pas kësaj ngjarjeje, dhe nuk kanë pse e mbajnë mend.

ADVERTISING

Psikologu amerikan, fitues i Nobelit, Daniel Kahneman do të ndihmojë ta kuptojmë fenomenin me ndarjen e personaliteteve tona në atë të përvojës dhe atë të kujtesës. Pra, personaliteti ynë i përvojës e jeton përditshmërinë, ndërsa ai i kujtesës na ndihmon t'i

bëjmë zgjedhjet e duhura. Dhe, kështu, nëse duam të zgjedhim se në cilën qebaptoje do të porosisim pesëshen në somune, këtë do ta bëjmë në sajë të personalitetit të kujtesës, të shijes më të mirë që na ka lënë qebaptoja herëve të kaluara - nuk do të shkojmë aty ku kemi ngrënë qebapë jocolësorë.

Kujtesa, në këtë interpretim, që tashmë është pranuar në shkencë, na ndihmon për të marrë vendime në të tashmen dhe të ardhmen. Rrjedhimisht, kujtesa ushqehet: nëse nuk mbajmë mend se njëra qebaptoje është më e mirë se tjetra, nuk mund të marrim vendimin e duhur.

3.

Nuk ka kalim automatik mes psikologjisë individuale dhe asaj shoqërore, por në së paku dy gjëra mund të hyjë në punë analiza e Kahnemanit. Një, që sikur tek individë edhe shoqërisë i nevojitet kujtesa në mënyrë që t'i ndihmohet rreth vendimeve të së ardhmes. Dhe dy, të kuptuarit se ndërsa harresa është automatike dhe e garantuar, kujtesa është një akt i vetëdijshëm i cili ndërmerret për të sotmen dhe të

ardhmen.

Dhe, kjo nuk është gjë e porsazbuluar për Kosovën. Pas çlirimit të vendit, forcat që u vendosën në krye të pushteteve komunale, pak me hatër pak me dhunë, vendosën që të ndryshohen emrat e rrugëve të qyteteve. U hoqën emrat që nuk u pëlqyen, u vendosën ata që u pëlqyen. Dhe nuk ishte hera e parë: çdo pushtet para tyre kishte bërë të njëjtën gjë. Dhe çdo pushtet e kishte bërë për të çuar në harresë disa emra, e për të paralajmëruar se jeta fillonte dhe do të zhvillohej me emra të rinj.

Emrat e rinj duhet të reflektojnë sistemin e vlerave të pushteteve të reja. Kështu, dikush që mund të quhej ati shpirtëror i letërsisë shqipe në Kosovë, Esad Mekuli apo siç njihej Sat Nokshiqi, nuk është emri me të cilin shpërblehen shkrimtarët e Kosovës.

Këtë, si dhe vendimet e tjera ishin produkte të Ministrisë së Kujtesës. Ajo, natyrisht, nuk ekziston fizikisht, por është pjesë e mendësisë së ndryshimeve revolucionare. Në Ministrinë e Kujtesës do të vendoset se si të quhen rrugët, emri i kujt është më

meritor për letërsi, çfarë është ngjarja e historisë së afërt a largët që duhet shënuar sot, shtatorja e cilit personalitet duhet të jetë më e madhe dhe sa metra afër qendrës së qytetit...

4.

Të kthehemi te Rambouillet.

Ka shumë për t'u kujtuar për të dhe çdo kujtim, siç u tha më sipër, shërben për të folur për të tashmen e të ardhmen. Kështu, ky është një rrëfim i pafund.

Prej atij rrëfimi të pafund, të nxjerrim një element i cili nuk është përmendur shpesh e iu dha harresës: pse u mbajt ky takim në Francë?

Dhe, përgjigja ishte se Franca e asaj kohe kishte për president Jacques Chiracun dhe ministër të Jashtëm, Hubert Vedrinen. Presidenti Chirac e vendosi Francën në një pozicion të hallkës së rëndësishme të krijimit të unitetit transatlantik dhe Hubert Vedrine së bashku me homologët gjermanë, së pari Kinkel e pastaj Fischer forcoi boshtin franko-gjerman rreth çështjes së Kosovës. Dhe, në traditën franceze, e tëra kjo u bë në një dialog intelektual disavjeçar mes pushtetit dhe qarkut të mbledhur rreth revistës Esprit, si Pierre Hasner,

Pascal Bruckner e André Glucksmann apo miku i madh nga Sciences Po, Jacques Rupnik.

Përse duhen nxjerrë këta emra e fakte prej harresës kolektive? Sepse, siç do të shpjegojë Kahneman, e kaluara shërben për të folur për të tashmen e të ardhmen, për vendimet rreth tyre. E, nuk ka mundësi që kjo të bëhet nëse nuk përcaktohen fillimisht së paku faktet elementare, e ato janë se përtej paragjyqimeve tradicionale ndaj Francës, ishte një gjeneratë udhëheqëse franceze që është meritore për lirinë e Kosovës dhe për ditët e saj të para të pasçlirimit, të demonstruar me shpirtin e madh dhe bujar të Bernard Kouchnerit, kryeadministratorit të parë të UNMIK-ut.

Ky shkrim në fakt, mori, siç mund të lexohet, vetëm për shkas Rambouilletnë. Kemi hyrë në 25-vjetorin e çlirimit të Kosovës dhe përderisa kalojnë me të shpejtë ditët drejt 12 qershorit dhe hyrjes së forcave çlirimtare të NATO-s, do të nxjerrë përditë nga mallkimi i harresës emra miqsh nga bota demokratike që e bënë të mundur këtë transformim epokal në historinë e Kosovës.

Fakti i kalimit nëpër harresë të jubileut të Rambouilletsë nuk duhet të lejojë që kjo t'i ndodhë jubileut të çlirimit. koha

“E DREJTA E MEDIAS” ÇËSHTJA “AMBROZIA META”

MAL BERISHA

Si e aktualizoi rëndësinë e librit

Libri “E DREJTA E MEDIAS” shkruar nga Dr. Brikena Kasmi, në vitin 2017, në të vërtetë është një manual shumë i rëndësishëm për të kuptuarit e Rolit të Medias në shoqëritë demokratike, mënyrën e organizimit të lirë, kushtet në të cilat operohet dhe format e shpërndarjes së lajmeve, opinionëve apo politikave të caktuara të grupeve të caktuara.

Pa u ndalur tek pesë kapitujt e librit, të cilët sjellin një parashtrim shumë profesional, të thellë në brendi dhe të lehtë në formën e të kuptuarit, duke filluar që nga:

- Liria e Shprehjes,
 - Drejhtësia e Medias,
 - Zhvillimet Mediatike,
 - Biznesi i Medias, dhe,
 - Struktura e Organizimit të Medias,
- Nisur nga rasti AMBROZIA, Marr shkas të ndalem tek e para: LIRIA E MEDIAS.

Këto ditë, ku më shumë, ku më pak e diku - diku hiç fare, është vënë në debat publik incidenti i Kryeministrit Rama me gazetaren e njohur Ambrozia Meta. Shumë kush e quan skandal, dikush tjetër incident, dikush një përkëdhelje “miqësore” ajo vetë Ambrozia e quan poshtërim.

Pikërisht për këtë po I referohem librit

të Dr. Brikena Kasmit dhe pikërisht Rolit të medias në “shpërndarjen e informacionit”. Aatoria ndalon tek MBROJTJA E LIRISË SË SHPREHJES dhe arësyet përse duhet ta mbrojmë atë, pikërisht tek:

- E drejta e individit për të dhënë opinionë,
- E drejta e publikut për t’u informuar,
- E drejta e shoqërisë në rrjedhën e lirë të informacionit,
- Roli i medias si mbikëqyrëse,
- Mardhënjet e të drejtës së medias me të drejtën e të tjerëve.

Të gjithë këta elementë si dhe çështjet tjera të parashtruara në këtë libër janë shtjelluar më së miri, por nisur nga rasti AMBROZIA, Roli i Medias si “ruajtëse” (mbikëqyrëse) bëhet edhe më aktuale sipas autores:

“Një ndër arësyet për se duhet të mbrohet media është e lidhur me rolin historik që është përsosur ndër shekuj si mbikëqyrëse, WATCHDOG. (Ky term është i lidhur me atë përqëndrimin që qeni ka në mbrojtjen e vet dhe nuk ka asnjë nënkuptim negativ, shën. Im). Në vendet me demokraci në zhvillim, sipas autores, gazetari shpesh ndjehet i/e intimiduar, kërcënuar, i/e pamundur të bëjë detyrën e saj/tij. Influcencat politike, oligarkike dhe të dëmshme bëjnë që roli i medias si mbikëqyrëse (watchdog) të jetë vulnerabël, e për pasojë të kthehet në një rol të përzier që ndërhyt ose që nuk ka rezultate.” Aatoria



shton:

“Në kohërat kur publiku ka humbur besimin te politika, ekzekutivi, gjyqësori, Pushteti i Katërt, i përfaqësuar nga Media luan një rol të rëndësishëm. Roli mbikëqyrës i medias lidhet me pushtetin që ajo zotëron, besimin që përçon e mundësitë për të ndryshuar politikat.”

Në fakt libri i Dr. Brikena Kasmit, nuk do të gjente zbatim më të mirë se sa në rastin “AMBROZIA” kur të lexojmë në rreshtat e mëposhtëm, citoj: “Nëpërmjet ndikimit që media ka tek

publiku forcohet pushteti i saj për llogaridhënje ndaj bërjes së detyrës nga pushtetarët. Ky ndikim luan rolin e një motivuesi për shmangien e ABUZIMIT, KORRUPSIONIT, ASPEKTEVE TË TJERA TË KUNDRALIGJËSHME, në ushtrimin e pushtetit. Disa politikanë shpesh kanë frikë nga media në ushtrimin e detyrës, çfarë e bën atë (median) një ruajtëse ndaj këtyre keqbërjeve.”

Ky postim le të jetë jo vetëm një ftesë për tërë njerëzit e medias që ta gjejnë veten në rradhët e këtij libri kaq të

vlefshëm, teorikisht të argumentuar shkëlqyeshëm, praktikisht të ilustruar dhe aktualisht më të domosdoshëm dhe më bindës se asnjëherë, si në rastin “AMBROZIA” Ky rast më bëri të hulumtoi në raste të ngjashme dhe që kanë bërë bujë në mediat ndërkombëtare:

VITI 2014 – Presidenti turk Recep Tayyip Erdoğan përfshihet në një sulm kundër gazetarit amerikan të CNN – it Ivan Watson;

VITI 2016: - Presidenti i Filipineve Rodrigo Duterte përplaset me gazetarin Mariz Umali i cili e pyet atë në lidhje me drogat që drejtoreshin nga vetë presidenti;

VITI - 2018 Presidenti Trump, e sanksionon gazetarin Xhim Akosta, të cilin e kthen Gjakata Amerikanë përsëri në konferencat e shtypit të presidentit. (Eh, po aty ku funksionon edhe media edhe drejtësia!);

VITI – 2019 – Presidenti rus Vladimir Putin sulmon gazetaren e televizionit amerikan NBC Megyn Kelly gjatë një Forumi Ekonomik Ndërkombëtar në Shën Petërburg;

VITI 2022 – Edi Rama përplaset me gazetarin Klevin Muka dhe e sanksionon atë.

Falemnderit Dr. Brikena Kasmi për mundësinë që ju keni dhënë njerëzve të medias për të patur një udhëzues perfekt për kryerjen e misionit të tyre fisnik!

Me GUXIM!

EFEKTET EKONOMIKE TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE NË TURIZËM!

IRENA BEQIRAJ

Në Maj të vitit 2015 u miratua ligji për Investimet Strategjike, edhe kriteret kryesore për cilësimin e një investimi si strategjik ishin vetëm dy:

Interesi publik që ka në thelb një investim, si dhe kriteri financiar, që tregon fuqinë dhe potencialin për realizimin e investimit.

Edhe interesi publik në përzgjedhjen e një investimi strategjik duhet të vlerësohet sipas vlerës së investimit, kohës së realizimit, zhvillimit ekonomik rajonal dhe lokal, hapjes së vendeve të reja të punës, produktivitetit dhe vlerës së shtuar të tij.

Për të lehtësuar kostot e biznesit, investitorëve të sektorit të resorteve në zonat turistike Këshilli i Investimeve i drejtuar nga Kryeministri mund t’u jepte jo vetëm akses në pasuri private dhe publike por edhe shërbime publike sepse investimi në shkëmbim të avantazhit konkurrues të krijuar nga qeveria do të ofronte përfitime të shumëfishta për ekonominë lokale

dhe të vendit .

Çfarë ka ofruar qeveria në këto 10 vjet?

Sipas vendimeve të miratuara, qeveria u ka ofruar investitorëve mbi 5.8 km² tokë bujqësore dhe truall kryesisht në zonën e çmuar bregdetare jugore, përmes kontratave të qirasë 1 euro.

Investitorët që janë kualifikuar të bëjnë investime në turizëm kanë përfituar jo vetëm tokë në zonat bregdetare, por qeveria ju ka garantuar me anë të fondeve të buxhetit infrastrukturë direkte si dhe infrastrukturë ndihmëse, si furnizim me ujë kanalizime, rrugë dytësore si dhe investime në shpërndarjen e energjisë duke përshtatur rjetin e amortizuar, dhe përfitime të tjera.

Nga llogaritjet konstatohet se çdo vit në dekadën e fundit për të lehtësuar kostot dhe bizneset e investitorëve të sektorit të resorteve në zonat turistike është investuar direkt deri 400 milionë Euro nga buxheti i shtetit (me fondet e brendshme), pra gjithësej rreth 3.2 miliardë euro nga taksat tona.

Por le të shikojë çfarë kanë dhënë mbrapsht investimet strategjike?

Pra ndërsa kanë marrë 5.8km² tokë edhe rreth 3.2 miliardë euro nga buxheti ishte përjashtuar nga investimet strategjike AIDA krenarisht deklaroi se vlera e investimeve strategjike është 4.4 miliardë Euro. AIDA po ashtu deklaroi se Investimet strategjike në turizëm kanë prurë një shtesë punonjësish në sektorin e turizmit prej 25.040 individë.

Por, nëse i referohemi analizës sektoriale të Bankës Botërore të efektit që kanë investimet në turizëm në krijimin e vendeve të reja të punës rezultoi se për çdo 10 milion Euro investime në turizëm duhet të krijoheshin deri 130 vende pune direkte dhe 60 indirekte. Pra këto nga 4.4 miliardë Euro duhet të kishin prurë të paktën 57 mijë vende pune të reja direkt në turizëm dhe 36 mijë vende pune indirekt nga sektorë që lidhen me turizmin (bujqësi, transport, kulturë etj.)

Por të ofruara më së shumti si një miks ndërtimesh rezidecash private individuale me pak përzjerje strukturash hoteliere, ato nuk e kanë kaluar dot as testin e shumë propaganduar të krijimit të vendeve të reja të

shumëkërkaura të punës.

Por pamjaftueshmëria për të prodhuar mirëqenie për banorët e zonave bregdetare, nuk përfundon këtu. Me anë të një tjetër ligji të miratuar për vitin 2020 ligji “Për menaxhimin e integruar të zonave bregdetare” dëmtohen edhe më rëndë intereset e banorëve dhe pronarëve të pronave në bregdet.

Ky ligj i’u heq pronarëve të tokave në bregdet të drejtën për shitjen apo zhvillimin e lirë të tokave të tyre duke i dhënë shtetit të drejtën e parabljes të çdo toke private në bregdet ose duke i detyruar pronarët që zhvillimi i tyre mund të bëhet vetëm me kontrata PPP ose si investim strategjik.

Ligji ndërhyt brutalisht në vullnetin e pronarëve të tokës në bregdet, duke e detyruar atë t’ja shesë pronën së pari shtetit, me një cmim të paracaktuar dhe jo me vlerën e përcaktuar në treg, duke e shpronësuar atë me vlera qesharake.

Ligji i Investimeve strategjike edhe akte të tjera ligjore dhe nënligjore të miratuara këto 10 vjet për menaxhimin shitjen e tokave në bregdet nuk

janë gjë tjetër vetëm struktura nxitëse të njëashme të transferimit “e ligjshëm” të vlerës nga publiku dhe banorët e thjeshtë tek një grup i caktuar njerëzish që jo fare çuditërisht janë edhe përfitues të kontratave të tjera publike. Edhe pse ky transferim është bërë gjoja në emër të krijimit të vlerave shtesë, apo vendeve të punës, kjo nuk ka ndodhur.

Kryeministri në intervistën e tij të fundit nuk e ka pranuar ekzistencën e korrupsionit në akses, (sepse është shumë i fokusuar në luftën kundër korrupsionit të punonjësve e postës) por herët a vonë llogaritë bëhen.

Kur jep me diskrecionin personal të plotë, pa transparencë 1 lek pasuri të publikut duke marrë mbrapsht një qindarkë, kjo qasje klasifikohet pa asnjë mëdyshje korrupsion me anë të aksesit.

Le të vijmë kapitali nga të dojë nga Amerika, Kina, Arabia, Europa, apo edhe vetë Zoti, le të kërcejë e veshur me kostum popullor gjithë vitin ministria e tij e turizmit në Berlin, me këtë qasje mirëqenia e këtij vendi është drejt kurkundit edhe zhvillimi në zgrip.

JANUSZ BUGAJSKI

AMERIKA DHE RUSIA TASHMË JANË NË LUFTË

Sulmi që Moska ndërmori kundër Ukrainës, është shndërruar në luftë midis Rusisë dhe Shteteve të Bashkuara. Ndonëse lufta është në një fazë ende të vakët; ajo mund të nxehet në mënyrë domethënëse gjatë vitit të ardhshëm. Qëllimi i Moskës është të përçajë Perëndimin dhe të pushtojë territoret që dikur i përkisnin perandorisë sovjetike.

Sulmet e saj joushtarake ndaj Perëndimit, kanë filluar mbi dy dekada më parë kur Putini u bë president – veçanërisht përmes sulmeve dezinformuese, korruptimit të politikës dhe varësisë energjetike. E pikërisht për shkak të reagimit të dobët të Uashingtonit, Kremli e përshkallëzoi sulmin në luftë të armatosur ndaj Ukrainës. Në shkurt të vitit 2022, Putini ia dha një paralajmërim Uashingtonit, sipas të cilit NATO duhej të anulonte vendimin e saj për të përfshirë Evropën Qendrore në Aleancë si dhe duhej të hiqte të gjitha armët pranë kufijve të Rusisë. Për më tepër, teksa Ukraina aspironte anëtarësimin në NATO për t'u vetëmbrojtur, Moska donte ta ndalonte me çdo kusht këtë proces.

Sipas përlllogaritjeve të saj, Kievi nuk

do të rezistonte gjatë, mbështetja e Perëndimit për Ukrainën do të ishte e përçarë, nuk do të kishte sanksione ekonomike dhe popujt e Perëndimit do të lodheshin shpejt nga lufta. Për më tepër, Moska vijon të mbështetet mbi retorikën se fitorja e Rusisë është e pashmangshme.

Kremli e konsideron të ardhmen e Ukrainës vendimtare për të ardhmen e Rusisë, pasi pa nënshtrimin ose zhdukjen e tërësishtme të Ukrainës, federata ruse do të shpërbëhet. Në fakt, kjo është pikërisht çfarë duhet t'i inkurajojë qeveritë perëndimore që të mbështesin Ukrainën të fitojë luftën. Nëse Uashingtonit i duhet të zgjedh mes kapitullimit të Ukrainës të shoqëruar me fuqizimin e Rusisë dhe fitores së Ukrainës që shoqërohet me shpërbërjen e Rusisë, atëherë qëllimi nuk mund të jetë veçse shpërbërja e perandorisë së fundit të Evropës.

Alternativa e parë, pra fitorja e mundshme e Rusisë në Ukrainë, i ka bindur disa anëtarë të NATO-s se kjo do të thotë luftë më përfshirëse në të ardhmen. Ministrat e Mbrojtjes të Britanisë së Madhe, Gjermanisë, Polonisë, Norvegjisë dhe disa aleatëve të tjerë, janë të mendimit se Perëndimi duhet të

përgatitet për një konflikt të drejtpërdrejtë me Rusinë. Paralajmërimet e tyre synojnë të tërheqin vëmendjen në tri pika: së pari, Evropa nuk mund të vazhdojë të varet nga ShBA-ja, veçanërisht nëse Trumpi zgjidhet sërish president; së dyti, Evropa vijon të jetë e papërgatitur dhe e keqpajisur ushtarakisht; dhe, së treti, çfarëdo lëshimi territorial nga ana Ukrainës kundrejt Rusisë, do ta inkurajonte Moskën që të përballej ushtarakisht drejtpërdrejt me NATO-n. Ndonëse mundësia kërcënuese e një lufte bërthamore ngjall frikë në mesin e zyrtarëve perëndimorë, (duhet kuptuar se) liderët rusë nuk do të bënin vetëvrasje duke i përdorur ato kundër NATO-s, pasi sulmet bërthamore të NATO-s do të zhduknin nga faqja e dheut të gjitha qytetet kryesore të Rusisë. Ashtu si elita sovjetike, klika aktuale e zyrtarëve të korruptuar rusë ka për qëllim të mbijetojë dhe të mbrojë të ardhmen e vet politike dhe pasurinë e vet. Megjithatë, një rrezik domethënës që po shfaqet në horizont është hezitimi i mundshëm i Uashingtonit për të ndërhyrë në rast se Rusia sulmon ushtarakisht në territoret e NATO-s. Shkatërrimi i disa objekteve infrastrukturore apo ushtarake pa një kundër-

përgjigje nga aleatët, nën udhëheqjen e SHBA-ve, do t'ia shtonte ambiciet Moskës.

Atëherë, Uashingtoni do të ishte përballë një zgjedhjeje të vështirë: ose do të braktiste aleatët e vet ose do të detyrohej të hynte në një tjetër luftë evropiane. Prandaj, vendosja e forcave dhe bazave amerikane përgjatë frontit lindor të NATO-s, që nga Estonia e Polonia e deri në Rumani e Shqipëri, është e rëndësishme dhe shfaq angazhimin e ShBA-së.

Një luftë e drejtpërdrejtë ShBA-Rusi mund të shmanget nëse, përgjatë muajve të ardhshëm, Ukraina armatoset plotësisht dhe kështu mund ushtrinë ruse pasi, tashmë, forcat e saj ushtarake i kanë treguar aftësitë e veta. Në të njëjtën kohë, ShBA-ja dhe BE-ja kanë ekonomi dhe burime shumë më të mëdha se Rusia dhe pikëpyetja e vetme është vullneti dhe vendosmëria e liderëve të Aleancës për t'i siguruar Ukrainës armë dhe municione. Derisa disa vende evropiane tashmë po i zgjerojnë industrinë e veta të mbrojtjes dhe po e shtojnë ndihmën ushtarake për Ukrainën, vihet re edhe konsensusi i fortë dypartiak për NATO-n dhe Ukrainën në të dy dhomat e Kongresit

të ShBA-së. Sondazhet e fundit të opinionit publik, gjithashtu tregojnë se shumica dërrmuese e popullit amerikan mbështet armatosjen e Ukrainës. Shumë republikanë me peshë janë të vetëdijshëm për urgjencën dhe rëndësinë e mposhtjes, nga Kievi, të një prej kundërshtarëve kryesorë të Amerikës.

Gjysma e ushtrisë profesioniste të Rusisë tashmë është shpartalluar në Ukrainë dhe, duke shpenzuar më pak se pesë përçind të buxhetit vjetor të Amerikës për mbrojtjen, ky misioni mund të përmbushet.

Që politikëbërësit ndërkombëtarë të Uashingtonit të triumfojnë në plan afatgjatë, ata duhet të inkurajohen të përmbushin parimet e tyre, ndërsa izolacionistët të mos votohen në nëntor. Në të njëjtën kohë, administrata Biden duhet të përdorë mënyra të guximshme dhe inovative për të armatosur Ukrainën, duke përfshirë përdorimin e miliarda dollarëve të aseteve të ngrira të shtetit rus në Perëndim dhe dhënie të armëve të tepërta të cilat nuk janë më të nevojshme për forcat amerikane.

Beteja kyçe e kësaj lufte midis Rusisë dhe Amerikës është fitorja e Ukrainës, duke çliruar të gjitha territoret e veta. Kjo do të parandalojë një konflikt më të gjerë dhe një luftë mirëfilltazi të zjarrtë midis Amerikës dhe Rusisë. /Dita

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazonin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:

020 7018 7929

073 4066 5946

POROSISNI kartat e biznesit tuaj

Për çdo konsultim mund të vini në çdo kohë në zyrat tona

Na kontaktoni:

020 7018 7929 073 4066 5946 078 5997 7545

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London, E13 8HT



AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Dotech
website 

Adresa e zyrave:
30 Avenons Road
London E13 8HT



Na kontaktoni:
Tel: 020 7018 7929
Mob 073 4066 5946
Mob: 078 5997 7545